	ekonomik vendor 7) Shërbimet në fushën e sigurisë publike 8) Shërbimet në fushën e funksioneve dhe kompetencave të deleguara..... Për çdo shërbim (por pa u kufizuar) informacion përshkrues mbi: ✓ Instrumentin për administrimin e shërbimit ✓ Sistemin e administrimit të performancës së shërbimit bazuar mbi standardet ✓ Sistemin e treguesve, përfshirë edhe aspektin gjinor për matjen e performancës ✓ Strukturën përgjegjëse për prezantimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e performancës së shërbimit, përfshirë edhe aspektin gjinor		Vendet e caktuara për njoftimet publike Tabela e Informacionit			
2.	**Shërbimet administrative** Përfshin bërjen publike të shërbimeve publike që ofron bashkia sipas fushave të përcaktuara nga ligji 139/2015 1) Shërbimet administrative në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike		a) Në faqen zyrtare të internetit Bashkisë Rrogozhinë -> "Shërbimet Publike" Programi i Sherbimeve – Bashkia Rrogozhine Sherbime-administrative.pdf Vërtetim-për-trajtim-me-ndihmë-ekonomike.pdf	Menjëherë	Kryetari i Bashkisë	Koordinatori për të drejtën e informimit

CamScanner



CamScanner

	2) Shërbimet administrative në fushën e shërbimeve sociale 3) Shërbimet administrative në fushën e kulturës,sportit dhe shërbimeve argëtuese 4) Shërbimet administrative në fushën e mbrojtjessë mjedisit 5) Shërbimet administrative në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotavepublike, natyrës dhe biodiversitetit 6) Shërbimet administrative t në fushën ezhvillimit ekonomik vendor 7) Shërbimet administrative në fushën e sigurisëpublike Shërbimet administrative në fushën efunksioneve dhe kompetencave të deleguara Për çdo shërbim (por pa u kufizuar) informacionpërshkrues mbi: - Strukturat përgjegjëse për ofrimin e shërbimit - Adresën postare/elektronike të strukturave/ njësive/sporteleve që ofrojnë shërbime administrative - Procedurat që duhen ndjekur për të përfituarshërbime administrative - Oraret e punës së strukturave/njësive/sporteleve që ofrojnë shërbime administrative - Tarifat për shërbimet administrative - Rregullat për mënyrën e kryerjes së pagesës - Subjektet që përjashtohen nga tarifat		Shërbimet-në-fushën-e-kulturës.pdf mjedisi-28092021143056.pdf Drejtoria-e-Bujqesise-ne-sherbim-te-qytetareve.pdf Kërkesë-për-dhënie-me-qera-të-asetevesi-ndërtesë.pdf Policia-e-bashkisë-dhe-e-komunës-ka-për-detyrë.pdf zyra-gjendjes-civile.pdf Vendet e caktuara për njoftimet publike Tabela e Informacionit			

CamScanner

3	**Kontratat publike**. Përfshin bërjen publike të: - Objektit të kontratës publike - Numrit të referencës së procedurës/kontratës - Llojit të procedurës - Termave dhe kushteve të kontratës - Kohëzgjatjes së kontratës - Vlerës së kontratës - Dhënave të autoritetit kontraktor - Dhënave të kontraktorit/nënkontraktorit	Neni 7/ i ligjit Nr. 119/2014 si dhe neni 25 dhe 71 i VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik	Në faqen zyrtare të internetit Bashkisë Rrogozhinë BASHKIA RROGOZHINE Sherbime qe ofron bashkia – Bashkia Rrogozhine Seksioni IV: Kushtet dhe termat e Kontratës(Kushtet e Përgjithshme dhe të Vecanta të Kontratës) Vendet e caktuara për njoftimet publike Tabela e Informacionit	Publikimi brenda 5 (pesë) ditëvenga nënshkrimi ikontratës	Kryetari i Bashkisë	Kryetari i Bashkisë

CamScanner

	- Treguesve për matjen e përmbushjes sëkontratës - Strukturave publike përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe monitorimin e kontratës - Procedurave që duhet ndjekur për të bërë njëankimim - Raporteve të kontrollit, monitorimit dheauditimit mbi zbatimin e kontratës					
4	**E drejta e ankesës dhe vërejtjes në lidhje me shërbimet** Përfshin bërjen publike të: 1. Procedurave për të bërë ankesa apo vërejtje nëlidhje me shërbimet 2. Adresës postare/elektronike për depozitimin e ankesave apo vërejtjeve		a) Në faqen zyrtare të internetit Bashkisë Rrogozhinë <u>Sherbime qe ofron bashkia – Bashkia Rrogozhine</u> <u>E drejta e ankesës dhe vërejtjes në lidhje me shërbimet</u> Vendet e caktuara për njoftimet publike Tabela e Informacionit	Brenda 10 ditëve nga shpallja e miratimit	Kryetari i Bashkisë	Koordinatori për të drejtën e informimit
Fusha 5 - Legjislacioni dhe aktet e brendshme rregullatore						
Nr.	**Informacioni që bëhet publik pa kërkesë**	**Referenca ligjore**	**Mënyra e bërjespublike së këtij informacioni**	**Afati kohor për publikim**	**Organi miratue s**	**Organi përgjegjës për publikimin**

CamScanner

1.	**Legjislacioni dhe aktet e brendshme rregullatore:** 1) I organizuar (jo i detyrueshëm) sipas fushave: - Fusha e organizimit dhe funksionimit tëbashkisë - Fusha e veprimtarisë ekonomiko-financiare - Fusha e qeverisjes së mirë vendore (integriteti, etika, anti-korrupsioni, transparenca,llogaridhënia etj) - Fusha e infrastrukturës dhe shërbimeve publike - Fusha e shërbimeve sociale - Fusha e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese - Fusha e mbrojtjes së mjedisit - Fusha e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit - Fusha e zhvillimit ekonomik vendor	Neni 7/b i ligjit nr. 119/2014	a)Në faqen zyrtare të internetit Bashkisë Rrogozhinë -> Këshilli Bashkiak Legjislacioni – Bashkia Rrogozhine LEGJISLACIONI – Bashkia Rrogozhine Organizimi dhe funksionimi i Bashkisë Rregullorja e brendshme e bashkise Rrogozhine • Fusha e organizimit dhe funksionimit të bashkisë • Fusha e veprimtarise ekonomiko-financiare • Fusha e infrastruktures dhe sherbimeve publike • Fusha e sherbimeve	Menjëherë pasbotimit në fletore zyrtare. Vendimet, urdhëresat dheurdhrat e këshillit dhe kryetarit bashkisë brenda 10 ditëve nga data e miratimit t ëtyre	Kuvendi i Shqipërisë Këshilli i Ministrav e Ministri Këshilli Bashkiak Kryetari i Bashkisë	Koordinatori për të drejtën e informimit

CamScanner

			sociale • Fusha e mbrojtjes se mjedisit • Fusha e bujqesise, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyres dhe biodiversitetit • Fusha e zhvillimit ekonomik vendor • Fusha e sigurise publike			

CamScanner

	- Fusha e sigurisë publike - Fusha e funksioneve dhe kompetencave tëdeleguara 2) Çdo fushë duhet të përmbajë: - Aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse - Dokumentet politike kombëtar përkatës - Vendimet, urdhëresat dhe urdhrat e këshillit tëbashkisë me karakter normativ - Vendimet, urdhëresat dhe urdhrat e kryetarit tëbashkisë me karakter normativ - Dokumentet politike vendor		Vendet e caktuara për njoftimet publike Tabela e Informacionit			
Fusha 6 - Pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje						
Nr.	**Informacioni që bëhet publik pa kërkesë**	**Referenca ligjore**	**Mënyra e bërjes publike së këtij informacioni**	**Afati kohor për publikim**	**Organi miratues**	**Organi përgjegjës për publikimin**
1.	**Të dhënat e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik.** Përfshin bërjen publike të: 1. Emër mbiemër të koordinatorit 2. Adresën postare/elektronike të tij 3. Orarin e punës	Neni 16/2 ligjit Nr. 139/2015 dhe neni 10 ligji Nr. 146/2014	a)Në faqen zyrtare të internetit Bashkisë Rrogozhinë-> Konsultime Publike – Bashkia Rrogozhine Koordinator i njoftimit dhe konsultimit publik. – Bashkia Rrogozhine Vendet e caktuara për njoftimet publike Tabela e Informacionit	Menjëherë pas miratimit të urdhrit të caktimit të Koordinatorit	Kryetari i Bashkisë	Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik

CamScanner

2.	**Plani vjetor për procesin e vendimmarrjes mepjesëmarrje.** Përfshin bërjen publike të: 1. Akteve që do të konsultohen 2. Mënyrat e konsultimit 3. Afatet 4. Strukturat përgjegjëse	Neni 6/b i ligjitNr. 146/2014	a) Në faqen zyrtare të internetit Bashkisë Rrogozhinë -> –Konsultime Publike – Bashkia Rrogozhine Aktetet, mënyrat e konsultimit , afatet dhe strukturat përgjegjëse Vendet e caktuara për njoftimet publike Tabela e Informacionit	Brenda 10 ditëve nga data e miratimit	Këshilli Bashkiak Kryetari i Bashkisë	Sekretari i Këshillit Bashkiak Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik
3.	**Dispozitat e brendshme rregullatorë për këshillimin me publikun.** Përfshin bërjen publiketë: 1. Procedurave, afateve dhe mënyrat e organizimit për çdo formë/lloj konsultimi 2. Strukturat përgjegjëse për aktet e detyrueshmepër konsultim	Neni 18/2 i ligjit 139/2015 dhe	a) Në faqen zyrtare tëinternetit Bashkisë Rrogozhinë-> "Këshilli Bashkiak -> "Pasqyrimi i regjistrave" REGJISTRI I PROJEKT AKTEVE PER KONSULTIM PUBLIK, TE KESHILLIT BASHKIAK – Bashkia Rrogozhine	Brenda 10 ditëve nga data e miratimit	Këshilli Bashkiak Kryetari i Bashkisë	Sekretari i Këshillit Bashkiak Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik

CamScanner

			Vendet e caktuara për njoftimet publike Tabela e Informacionit			

4.	**Akte për të cilët është e detyrueshme zhvillimi i konsultimit publik.** Përfshin bërjen publike të: 1. Listës së akteve për të cilët është e detyrueshme zhvillimi i konsultimit publik	Neni 18/1 ligjit Nr. 139/2015 Neni 5/ç dhe 13/3 e ligji Nr. 68/2017 Neni 1/1 dhe 4/c e ligjit 146/2014	a) Në faqen zyrtare të internetit Bashkisë Rrogozhinë-> "Këshilli Bashkiak"- **Konsultime Publike – Bashkia Rrogozhine** Vendet e caktuara për njoftimet publike Tabela e Informacionit	Menjëherë	Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik	Sekretari i Këshillit Bashkiak Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik

CamScanner

5.	**Njoftimi për nismën vendimmarrëse me pjesëmarrje** Përfshin bërjen publike të: 1. Projektaktit, relacionin shpjegues dhe dokumentave shoqërues të tij. 2. Arsyeve të nevojshme për nxjerrjen e projektaktit, si dhe ndikimi që ai do të ketë 3. Afatit, vendit dhe mënyrën me të cilën palët e interesuara paraqesin ose dërgojnë rekomandimet e tyre; 4. Adresën e kontaktit të koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik të bashkisë ose të strukturës përgjegjëse për mbledhjen e rekomandimeve e të komenteve për projektaktin; 5. Vendin dhe datën e organizimit të takimit publik në rastet kur bashkia vendos për organizimin e tij	Neni 11, neni 13 dhe neni 14 i ligjit Nr. 146/2014	a) Në faqen zyrtare të internetit Bashkisë Rrogozhinë-> "Këshilli Bashkiak" Konsultime Publike – Bashkia Rrogozhine Pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje. – Bashkia Rrogozhine Model dhe shembull i Njoftimi për Konsultim Publik Vendet e caktuara për njoftimet publike Tabela e Informacionit	Menjëherë	Këshilli Bashkiak Kryetari i Bashkisë	Sekretari i Këshillit Bashkiak Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik
6.	**Procedura e marrjes dhe shqyrtimit të komenteve dhe rekomandimeve.** Përfshin bërjen publike të:	Neni 15 i ligjit Nr. 146/2014	a) Në faqen zyrtare të internetit Bashkisë Rrogozhinë-> "Këshilli Bashkiak"- Pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje. – Bashkia Rrogozhine Afati për dërgimin e komenteve dhe rekomandimeve **Deri ne dy jave pas takimit**	Menjëherë	Këshilli Bashkiak	Sekretari i Këshillit Bashkiak

CamScanner

	1. Adresën postare/ elektronike për dërgimin e komenteve dhe rekomandimeve 2. Afatin për dërgimin e komenteve dhe rekomandimeve 3. Mënyrën e mbajtjes së procesverbalit dhe regjistrimit të takimit publik për takimet publike 4. Mënyrën e trajtimit të komenteve dhe rekomandimeve 5. Mënyrën e dhënies së arsyeve për mospranimin komenteve dhe rekomandimeve		Bashkia Shijak | Bashkia Shijak , faqja zyrtare Bashkia Shijak | Bashkia Shijak , faqja zyrtare Ligji për njoftimin Konsultimin Vendet e caktuara për njoftimet publike Tabela e Informacionit			Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik
7.	**Procedurat që duhen ndjekur për të bërë një ankim** në lidhje me konsultimin publik. Përfshin bërjen publike të: 1. Subjektet ku mund të bëhet ankesa (Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale Këshilli i bashkisë, Kryetari i bashkisë;) 2. Adresën postare/ elektronike për dërgimin e ankesës 3. Procedurat për të bërë një ankesë në lidhje me këshillimin me publikun 4. Struktura përgjegjëse në nivel bashkie që regjistron dhe shqyrton ankesën	Neni 21 i ligjit Nr. 146/2014	a) Në faqen zyrtare të internetit Bashkisë Rrogozhinë-> "Këshilli Bashkiak" Pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje. – Bashkia Rrogozhine Rregulloret e Këshillit | Bashkia Shijak , faqja zyrtare Vendet e caktuara për njoftimet publike Tabela e Informacionit	Menjëherë	Këshilli Bashkiak	Sekretari i Këshillit Bashkiak Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik

CamScanner

8.	**Raporti vjetor për transparencën** në procesin e vendimmarrjes. Përfshin bërjen publike të: 1. Numrit të akteve të miratuara nga organet e bashkisë me konsultim publik gjatë një viti. 2. Numrin e përgjithshëm të komenteve dhe rekomandimeve të marra nga palët e interesuara; 3. Numrin e rekomandimeve dhe komenteve të pranuara dhe të refuzuara gjatë procesit të vendimmarrjes 4. Numrin e takimeve publike të organizuara	Neni 20/1 i ligjit Nr. 146/2014	a) Në faqen zyrtare të internetit Bashkisë Rrogozhinë-> "Këshilli Bashkiak" Konsultime Publike – Bashkia Rrogozhine Koordinator i njoftimit dhe konsultimit publik. – Bashkia Rrogozhine Vendet e caktuara për njoftimet publike Tabela e Informacionit	Brenda 10 ditëve nga data e miratimit	Këshilli Bashkiak Kryetari i Bashkisë	Sekretari i Këshillit Bashkiak Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik
9.	**Iniciativa qytetare.** Përfshin bërjen publike të: 1. Mënyrës dhe formës së paraqitjes së iniciativës qytetare	Neni 20/1 Ligji Nr. 139/2015	a) Në faqen zyrtare të internetit Bashkisë Rrogozhinë-> "Këshilli Bashkiak" Rregulloret e Këshillit – Bashkia Rrogozhine Regjistri i Peticioneve/Iniciativa Qytetare – Bashkia Rrogozhine Formatet për shkarkim nga qytetarët – Bashkia Rrogozhine	Brenda 10 ditëve nga data e miratimit	Këshilli Bashkiak	Sekretari i Këshillit Bashkiak

CamScanner

	2. Procedurave të shqyrtimit dhe e miratimit të iniciativës qytetare 3. Adresës postare/ elektronike për depozitimin e iniciativës qytetare. 4. Mënyrat dhe afatet e kthimit të përgjigjeve për mos miratimin e iniciativës qytetare		Vendet e caktuara për njoftimet publike Tabela e Informacionit			Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik
Fusha 7 - Informacion tjetër						
Nr.	**Informacioni që bëhet publik pa kërkesë**	**Referenca ligjore**	**Mënyra e bërjes publike së këtij informacioni**	**Afati kohor për publikim**	**Organi miratues**	**Organi përgjegjës për publikimin**
1.	**NJVV në proceset e integrimit evropian.** Përfshin bërjen publike të: 1. Të dhënave për projektet, nismat dhe veprimtarisë e bashkisë në kuadrin e integrimit në BE	Neni 7/1 i ligjit nr. 119/2014	a)Në faqen zyrtare të internetit Bashkisë Rrogozhinë -> KËNDI I BE Këndi i BE – Bashkia Rrogozhine Vendet e caktuara për njoftimet publike Tabela e Informacionit	Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre	Këshilli Bashkiak Kryetari i Bashkisë	Koordinatori për të drejtën e informimit
2.	**Bashkia dhe shoqëria civile.** Përfshin bërjen publike të: 1. Në tërësi të dhëna për grupet e interesit 2. Të dhëna për OJF, përfaqësuesit e medias, biznesit 3. Shërbimet që ofrohen nga organizata të ndryshme 4. Nismat advokuese, lobuese dhe monitoruese nga shoqëria civile	Neni 7/1 i ligjit nr. 119/2014	a)Në faqen zyrtare të internetit Bashkisë Rrogozhinë-> KËNDI I BE Këndi i BE – Bashkia Rrogozhine Vendet e caktuara për njoftimet publike Tabela e Informacionit	Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre	Këshilli Bashkiak Kryetari i Bashkisë	Koordinatori për të drejtën e informimit

CamScanner

3.	**Raporte, studime dhe vlerësime mbi zbatimin e Programit të transparencës.** Përfshin bërjen publike të: 1. Raporte, studime dhe vlerësime mbi PT 2. Sisteme/metodologji matje të PT	Neni 7/l i ligjit nr. 119/2014	a)Në faqen zyrtare të internetit Bashkisë Rrogozhinë-> KËNDI I BE Këndi i BE – Bashkia Rrogozhine Vendet e caktuara për njoftimet publike Tabela e Informacionit	Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre	Këshilli Bashkiak Kryetari i Bashkisë	Koordinatori për të drejtën e informimit
4.	**Strukturat komunitare** Përfshin bërjen publike të:	Neni 7/l i ligjit nr. 119/2014	a)Në faqen zyrtare të internetit Bashkisë Rrogozhinë-> KËNDI I BE Këndi i BE – Bashkia Rrogozhine	Brenda 10 ditëve nga data	Këshilli Bashkiak	Koordinatori për të drejtën e informimit

CamScanner

	1. Dhënave për strukturat komunitare në fshat 2. Dhënave për strukturat komunitare në qytet 3. Detyrat, kompetencat dhe kompetencat e strukturave komunitare 4. Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e këshillave komunitare		Vendet e caktuara për njoftimet publike Tabela e Informacionit	e miratimit të tyre		

Fusha 8 – Këshilli Bashkiak

Nr	Informacioni që bëhet publik pa kërkesë	Referenca ligjore	Mënyra e bërjes publike së këtij informacioni	Afati kohor për publikim	Organi miratues	Organi përgjegjës për publikimin
1	**Informacion rreth këshilltarëve:** Përfshin bërjen publike të: 1. Lista e këshilltarëve. 2. Biografi e shkurtër e këshilltarëve. 3. Kontakte të këshilltarëve nr. telefonit/ email-i zyrtar.	Neni 7 i ligjit Nr. 119/2014 Ligji Nr. 139/2015	a)Në faqen zyrtare të internetit- Anëtarët e Këshillit Bashkiak – Bashkia Rrogozhine Sekretari i Keshillit – Bashkia Rrogozhine b)Vendet e caktuara për njoftimet publike Tabela e Informacionit	Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre	Këshilli i NJVV	Këshilli i NJVV
2	**Informacion rreth komisioneve:** Përfshin bërjen publike të: 1. Përshkrimi dhe përbërja e komisioneve. 2. Njoftim për takimet e komisioneve. 3. Agjenda dhe dokumentet për diskutim. 4. Raportet e mbledhjeve të komisioneve për projekt aktet e diskutuara.	Ligji Nr. 139/2015, Neni 53- 54 Ligji 119/2014	a)Në faqen zyrtare të internetit- VKB-Komisionet-e-keshillit-2023-2027-azhornuar.pdf Komisionet e Këshillit – Bashkia Rrogozhine b)Vendet e caktuara	Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre	Këshilli i NJVV	Këshilli i NJVV

CamScanner

			për njoftimet publike Tabela e Informacionit			
3	**Kuadri rregullator i këshillit NJVV:** Përfshin bërjen publike të: 1. Ligje dhe udhëzime për qeverisjen vendore me fokus këshillat. 2. Rregullore e funksionimit të këshillit të NJVV-së. 3. Kodi i sjelljes dhe i parandalimit të konfliktit të interesave të këshilltarëve NJVVe. 4. Rregullore për marrëdhënien e këshillit NJVV me publikun dhe median. 5. Rregullore për paraqitjen dhe shqyrtimin e ankesave, vërejtjeve, kërkesave, peticioneve, dhe iniciativave qytetare.	Ligji nr. 139/2015	a)Në faqen zyrtare të internetit- Rregullorja e brendshme e bashkise Rrogozhine – Bashkia Rrogozhine b)Vendet e caktuara për njoftimet publike Tabela e Informacionit	Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre	Këshilli i NJVV	Këshilli i NJVV
4	**Mbledhjet e këshillit:** Përfshin bërjen publike të: 1. Njoftimi paraprak për mbledhjet (data, ora, vendi, agjenda). 2. Dokumente përgatitore për mbledhjet. 3. Procesverbalet dhe vendimet pas mbledhjeve. 4. Mbledhjet live të Këshillit .	Ligji nr. 139/2015	a)Në faqen zyrtare të internetit- Axhenda e Mbledhjeve – Bashkia Rrogozhine Proces verbalet e mbledhjes – Bashkia Rrogozhine Kalendari i Mbledhjeve te Keshillit Bashkiak dhe Plani i Aktivitete	Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre	Këshilli i NJVV	Këshilli i NJVV

CamScanner

			te Keshillit – Bashkia Rrogozhine b)Vendet e caktuara për njoftimet publike Tabela e Informacionit			
5	**Konsultimet publike:** Përfshin bërjen publike të: 1. Të dhënat e Sekretarit të Këshillit NJVV (Emër Mbiemër, telefon, adresë emaili). 2. Plani vjetor i konsultimeve të Këshillit. 3. Regjistri i projekt-akteve për konsultim. 4. Njoftimi i konsultimeve në faqen e internetit të Këshillit. 5. Përmbledhje e pas-konsultimit në raport zyrtar. 6. Raporti vjetor i transparencës së konsultime publike/dëgjesave publike.	Ligji nr. 146/2014	a)Në faqen zyrtare të internetit- Konsultime Publike – Bashkia Rrogozhine Sekretari i Keshillit – Bashkia Rrogozhine REGJISTRI I PROJEKT AKTEVE PER KONSULTIM PUBLIK, TE KESHILLIT BASHKIAK – Bashkia Rrogozhine Proces verbalet e mbledhjes – Bashkia Rrogozhine b)Vendet e caktuara për njoftimet publike Tabela e Informacionit	Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre	Këshilli i NJVV	Këshilli i NJVV
6	**Vendimet e Këshillit të NJVV:** 1. Projekt-Vendimet e Këshillit NJVV 2. Vendimet e Këshillit të NJVV	Ligji nr. 139/2015	a)Në faqen zyrtare të internetit- Projekt – Vendime te	Brenda 10 ditëve nga data e	Këshilli i NJVV	Këshilli i NJVV

CamScanner

	(relacionet dhe çdo dokument tjetër bashkëlidhur vendimit).		Keshillit Bashkiak – Bashkia Rrogozhine Vendime të Këshillit Bashkiak – Bashkia Rrogozhine b)Vendet e caktuara për njoftimet publike Tabela e Informacionit	miratimit të tyre		
7	**Kërkesat dhe përgjigjet drejtuar Këshillit NJVV:** 1. Procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe ankesës pranë Këshillit NJVV. 2. Formular për dorëzimin e kërkesave Këshillit NJVV. 3. Formular për dorëzimin e ankesave Këshillit NJVV. 4. Regjistër i kërkesave dhe përgjigjeve i Këshillit NJVV (përfshirë përgjigjen e dhënë, të anonimizuar)	Ligji nr. 119/2014	a)Në faqen zyrtare të internetit- Regjistri Ankese/Kerkese – Bashkia Rrogozhine b)Vendet e caktuara për njoftimet publike Tabela e Informacionit	Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre	Këshilli i NJVV	Këshilli i NJVV
8	**Veprimtaria e Këshillit, Komunikimi me Publikun dhe aspekte të tjera:** 1. Raporti vjetor i punës së këshillit. 2. Buxheti vjetor i këshillit. 3. Raporti vjetor i konsoliduar për zbatimin e buxhetit. 4. Kalendari vjetor për trajnimet. 5. Vlerësim i performancës së këshilltarëve nga aktorë	Ligji nr. 139/2015	a)Në faqen zyrtare të internetit- Rreth Keshillit Bashkiak – Bashkia Rrogozhine Raporte Performance – Bashkia Rrogozhine	Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre	Këshilli i NJVV	Këshilli i NJVV

CamScanner

	të brendshëm. 6. Vlerësim i performancës së këshilltarëve nga OSHC-të. 7. Regjistër i peticioneve dhe iniciativave qytetare. 8. Deklaratë publike e Titullarit/es së Këshillit për përmirësimin e transparencës. 9. Regjistër i OSHC-ve dhe ekspertëve lokalë. 10. Statistika		Regjistri i Peticioneve/Iniciativa Qytetare – Bashkia Rrogozhine b)Vendet e caktuara për njoftimet publike Tabela e Informacionit			

CamScanner

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË

Nr. 3030 Prot.

Rrogozhinë,më 21 / 02 /2026

Projekt-vendim

"PER PERLLOGARITJEN E NIVELIT TE PAGAVE PER BASHKINE RROGOZHINE SIPAS VENDIMIT Nr.103 ,date 11.02.2026"

Në mbështetje të nenit 113 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar; të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar; të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar; të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; të ligjit nr. 68/2018, "Për financat e vetëqeverisjes vendore"; të nenit 6, shkronja "c", dhe nenit 9 të ligjit nr. 35/2023, "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi"; të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 328, datë 31.05.2023, "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë dhe të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", të ndryshuar; të Vendimit nr. 52, datë 24.12.2025, "Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2026"; si dhe të Vendimit nr. 116, datë 12.03.2026, të ndryshuar me Urdhrin e Kryetarit nr. 159, datë 20.04.2026,

I propozojme Keshillit Bashkiak miratimin e ketij project-vendimi, si me poshte;

1. Të miratojë nivelin e pagave për funksionarët, nëpunësit civilë dhe punonjësit administrativë të Bashkisë Rrogozhinë, në zbatim të Vendimit nr. 103, datë 11.02.2026, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendim

Nr.	Emertesa e pozicionit të punës	Kategoria	Klasa	Paga për pozicion
1.	Kryetar Bashkie		1 C	246,000
2.	N / Kryetar Bashkie		1 C	189,625
3.	Keshilltare te Kryetarit te Bashkise		III – 2	109,000
4.	Sekretar I Keshillit Bashkiak	II	II – 2	144,525
5.	Administratore Njesia Sinaballaj		Lidhja Nr.8/4	143,500
6.	Administratore Njesia Kryevidh,Lekaj,Gose		Lidhja Nr.8/3	148,625

CamScanner

7.	Sekretari I Pergjithshem	I	Lidhja 1/5	174,250
8.	Drejtor Drejtorie (Aparati,Ligjzbatues,Sherbimesh)	II	II – 2	144,525
9.	Pergjegjes Sektori (Aparati) (Ligjzbatues)	III	III – 2	109,000
10.	Pergjegjes Sektori (Sherbimesh)	III	III – 2	102,000
11.	Pergjegjes Zyres Gjendjes Civile	III	III-3	102,000
12.	Pergjegjes Sektori (Aparati,Ligjzbatuesish,Sherbimesh)	III	III – 3	100,450
13.	Specialist (Aparati, Ligjzbatues)	IV	IV – 3	75,000
14.	Specialist (Sherbimesh)	IV	IV – 3	65,000
15.	Specialist (Aparati, Ligjzbatues)	IV	IV – 4	65,000
16.	Specialist (Sherbimesh)	IV	IV – 4	60,000
17.	Specialist i Zyres Gjendjes Civile	IV	IV-3	75,000
18.	Kryeinspektor IMTV/Policie Bashkiake (Ligjzbatues)	III	III – 2	109,000
19.	Inspektor IMTV/Policie Bashkiake (Ligjzbatues)	IV	IV – 3	70,000
20.	Polic Bashkiak (Ligjzbatues)	KP Lidhja.11		57,000
21.	Koordinator I dhunes ne familje / Koordinator komunitar		IV – 3	65,000
22.	Adminitrator Fshati,Njesia Sinaballaj			14,350
23.	Adminitrator Fshati,Njesia Kryevidh,Lekaj,Gose			14,862
24.	Adminitrator I Lagjes			24,600
25.	Keshilltare te Keshillit Bashkiak			24,600
26.	Punonjes Informacioni,Magazinjer,Taksa Mbledhes, Punetor gjelberim-pastrim, Shofer, Manovrator, Eskavatorist, Kaldaist, Elektricist,Hidraulik, Teknik Ndertimi,Punonjes Ujitje dhe Kullimi, Punonjes Kulture,Arti,Cerdhe, Punonjes Sherbimesh Kultura, Arketar Njesi, Topograf Njesi		Lidhja Nr.11	57,000
27.	Sanitare, Roje Objekti		Lidhja Nr.11	50,000
28.	Punetor sherbimesh		Lidhja Nr.11	50,000
29.	Inspektor I Pyjeve	Pika.9	IV-4	60,000
30.	Sekretare,Arkiv,Protokoll Njesi	Pika 5/b	IV-4	60,000
31.	Punonjes Sezonal			50,000

CamScanner

32.	Agronom	IV	IV-4	60,000

2. Ky vendim ka efekte financiare duke filluar nga data **01.01.2026**
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë, Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Financës dhe strukturat e tjera përgjegjëse, sipas kompetencave.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi

Duke ju falenderuar per bashkepunimin.

N/KRYETARI BASHKISË
USHTRUES I DETYRËS SË KRYETARIT
Andi **PROSHKA**

CamScanner

R E P U B L I K A E SH Q I P Ë R I S Ë
BASHKIA RROGOZHINË

Nr. 3030/ prot. Rrogozhinë, më 21.02.2026

Drejtuar: Këshilli Bashkiak

RELACION

"PËR PËRLLOGARITJEN E NIVELIT TË PAGAVE PËR BASHKINË RROGOZHINË SIPAS VENDIMIT NR. 103, DATË 11.02.2026"

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Ky projektvendim paraqitet për shqyrtim dhe miratim nga Këshilli Bashkiak Rrogozhinë me qëllim përcaktimin e niveleve të pagave të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar, nëpunësve civilë dhe punonjësve administrativë të Bashkisë Rrogozhinë, në përputhje me ndryshimet e fundit të miratuara nga Këshilli i Ministrave. Projektvendimi synon zbatimin e politikës së re të pagave në administratën e njësive të vetëqeverisjes vendore, duke garantuar zbatimin e një sistemi pagash të harmonizuar me administratën publike dhe përmirësimin e trajtimit financiar të punonjësve të bashkisë.

Në zbatim të VKM nr. 103, datë 11.02.2026, janë rishikuar kufijtë e pagave për funksionarët e zgjedhur dhe të emëruar, nëpunësit civilë dhe punonjësit administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Në këto kushte, Bashkia Rrogozhinë do të përshtasë nivelet e pagave të administratës së saj në përputhje me kufijtë e rinj të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave, duke respektuar klasifikimin e bashkisë sipas grupimit për efekt page dhe strukturën organizative të miratuar.

Rritja e niveleve të pagave synon:

- zbatimin e legjislacionit në fuqi;
- harmonizimin e pagave të administratës vendore me politikën kombëtare të pagave;
- rritjen e motivimit dhe të performancës së punonjësve;
- përmirësimin e aftësisë së bashkisë për të tërhequr dhe mbajtur burime njerëzore të kualifikuara;
- rritjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara ndaj qytetarëve.

CamScanner

Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij projektvendimi janë përllogaritur nga Grupi i Punës i ngritur me Urdhër të N/Kryetarit, Kryetar që Ushtron Detyrën nr. ___, datë ___/___/2026 dhe do të përballohen nga fondi i pagave i akorduar nga buxheti i shtetit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në zbatim të VKM-së nr. 103, datë 11.02.2026, efektet financiare fillojnë nga data 1 janar 2026.

Miratimi i niveleve të reja të pagave vjen si pasojë e ndryshimeve të miratuara nga Këshilli i Ministrave, për këtë arsye propozohet miratimi i projektvendimit "Për miratimin e niveleve të pagave të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar, nëpunësve civilë dhe punonjësve administrativë të bashkisë rrogozhinë", me qëllim zbatimin e plotë të legjislacionit në fuqi dhe garantimin e trajtimit financiar sipas kufijve të rinj të pagave.

Dr. Finance – Rezart VOGLI

Dr. Pol. Urbane – Tomorr THARTORI

Dr. Shërbime Mbështetëse – Valmira TROKA

Dr. Zhvillimi Ekonomik – Marsida THARTORI

Dr. Bujqësisë – Elton XHANI

Pol. Bashkiake – Lorenc BORIÇI

Dr. Juridik – Enkela BALLABANI

Dr. AKRSM – Orges TOSKU

Dr. Sh. Social – Ledian HASANI

Dr. Kadastrës – Megi TOSKA

IMTV – Armand BATUSHA

CamScanner

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË

Nr.2406 Prot.

Rrogozhinë, më 11 .06.2026

PROJEKT- VENDIM
Nr. , datë . 06. 2026

"PËR DHËNIEN E OPINIONIT MBI PROPOZIMIN PËR PLANIN E RI TARIFOR PËR UJËSJELLËSIN RROGOZHINË SIPAS SHKRESËS SË KËSHILLIT MBIKQYRËS TË SHOQËRISË RAJONALE UK DURRËS SH.A ME NR.3235.PROT DATË 08.06.2026"

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, mbështetur në shkresën "Kërkesë për mbledhjen e Këshillit Bashkiak" me Nr.3235. Prot datë 08.06.2026 të ardhur nga Këshilli Mbikqyrës i Ujësjellës Kanalizime Sh.a Durrës ku kërkohet në dhënia e opinionit të Këshillit Bashkiak Rrogozhinë si pronar aksioner në shoqërinë Rajonale UK Durrës sh.a mbi propozimin e një plani të ri tarifor për Bashkinë Rrogozhinë, mbështetur në këtë shkresë me propozim të Zëvendëskryetarit të Bashkisë ushtrues i detyrës së Kryetarit, I propozojmë Këshillit Bashkiak ,

TË V E N D O S I :

1. Dhënien e opinionit ___ Këshilltarë pro, ____ Këshilltarë kundër, ____ Këshilltarë abstenim, mbi propozimin për planin e ri tarifor për Ujësjellësin e Bashkisë Rrogozhinë sipas shkresës së Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë Rajonale UK Durrës Sh.A me Nr.3235. Prot datë 08.06.2026 bashkëlidhur këtij projektvendimi.
2. Ky vendim t'i përcillet sipas kërkesës për dhënie opinioni, Shoqërisë Rajonale UK Durrës Sh.A.
3. Ngarkohet për zbatimin dhe përcjelljen e këtij vendimi Kryetari i Bashkisë, Drejtoria Juridike pranë Bashkisë Rrogozhinë.
4. Ky projektvendim hyn në fuqi pas miratimit në këshill bashkiak sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar dhe pas Konfirmimit Ligjor nga ana e Prefektit të Qarkut Tiranë.

DREJTOR JURIDIK
ENKELA BALLABANI

N/ KRYETARI I BASHKISË
USHTRUES I DETYRËS SË KRYETARIT
ANDI PROSHKA

Adresa: BashkiaRrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË

Nr. 2406/1 Prot.

Rrogozhinë, më 11 .06.2026

Lënda: Relacion

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Rrogozhinë

Të nderuar anëtar të Këshillit Bashkiak,

Bazuar në shkresën Nr.3235. Prot datë 08.06.2026 të ardhur nga Këshilli Mbikqyrës i Ujësjellës Kanalizime Sh.a Durrës ku kërkohet në dhënia e opinionit të Këshillit Bashkiak Rrogozhinë si pronar aksioner në shoqërinë Rajonale UK Durrës sh.a mbi propozimin e planit të ri tarifor për Bashkinë Rrogozhinë, ju dërgojmë për marrje vendimi këtë projektvendim, për shkak se aplikimi i tarifave të reja kërkon në mënyrë taksative që Këshilli Bashkiak si pronar aksioner në Shoqërinë Rajonale UK Durrës, duhet të japë opinionin në lidhje me këtë propozim.

- Bashkëlidhur shkresa nr. Nr.3235. Prot datë 08.06.2026 të ardhur nga Këshilli Mbikqyrës i Ujësjellës Kanalizime Sh.a Durrës

DREJTOR JURIDIK
ENKELA BALLABANI

Adresa: BashkiaRrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE
UJËSJELLËS KANALIZIME DURRËS SH.A.
KESHILLI MBIKQYRES

Nr. 3235 Prot.

Durrës, më 09/04.2026

Lënda: Kërkesë për mbledhjen e Këshillit Bashkiak

KRYETARIT BASHKISË RROGOZHINË
Z.Edison Memolla

Adresa: Lagjja. nr. 1,Rruga e " Kavajës", Blloku "12 Shtatori" Rrogozhinë

I nderuar Kryetar!

Bazuar në Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, në Vendimin e Këshillit ministrave Nr 302 datë 11.05.2022 "Për Politikat Kombetare per Riorganizimin e Sektorit te Furnizimit me uje dhe largimit, trajtimit e perpunimit te ujerave te ndotura", ne marreveshjen date 22.07.2022 "Për krijmin e subjekteve me kompetenca të perbashketa(SKP) të ujësjellës kanalizimeve",është lidhur ndërmjet, Ministrise se Infrastruktures dhe Energjisë Bashkisë Durrës, Bashkive Kavajë, Krujë, Rrogozhinë dhe Shijak" është krijuar (SKP) Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës sha.

Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a.(SKP) në bashkëpunim me AKUK dhe Kompaninë e Konsulencës për forcimin Institucional në kuadër të Projektit të përfituar për përmirësimin e infrastrukturës së Ujësjellësit nga Agjencia Franceze për zhvillim AFD, për nevojat e arritjes së qëndrueshmërisë financiare për zhvillimin e aktivitetit te sajë dhe përmiresimit të vazhdueshëm të shërbimit ndaj konsumatoreve për furnizimin me uje të pijshem dhe grumbullimin , largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura në të gjithë zonën e sajë të shërbimit ku përfshihen Bashkia Durrës, Bashkia Kavajë, Krujë, Rrogozhinë dhe Shijak, ka pregatitur programin e zhvillimit ekonomik 2027-2031 dhe propozimin per planin tarifor pjesë e këtij programi.
Ndryshimi i planit tarifor i Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a. është miratuar paraprakisht nga Këshilli Mbikqyrës me Vendimin nr. 3 , Date 26.02.2026 sipas Propozimit të Draft Plan biznesit 2027-2031 të paraqitur nga Ekspertët e Kompanisë së Konsulencës.

Sa më sipër referuar legjislacionit dhe akteve te Entit Rregullator te Ujit, Vendimit Nr 15 datë 16.05.2024 të Entit Rregullator të ujit "Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës. sh.a"

CamScanner

2024-2026 shoqëria brënda datës 30 Qershor 2026 duhet të aplikojë për ndryshim të argumentuar të tarifave sipas metodologjise së tarifave të ERRU, aplikimi për tarifa të reja pranë ketij institucioni kerkon ne menyre taksative që Këshilli Bashkiak i secilës bashki si pronar aksioner në shoqërine rajonale UK Durres, te jape opinionin e tij brënda 30 diteve në lidhje me këtë propozim, duke e trajtuar si pikë të veçantë e rendit të ditës.

Për sa më sipër, Ju lutemi dhe kërkojme të planifikoni sa më shpejt që të jetë e mundur trajtimin në mbledhjen e Këshillit Bashkiak të radhës këtë çështje jetike për përmirësimin e qëndrueshmërisë financiare të Shoqerisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a dhe shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm ndaj konsumatorëve.

Bashkëlidhur po ju dërgojme propozimin per planin tarifor, Vendimin e Keshillit Mbikqyres për miratimin e këtij plani.

KESHILLI MBIKQYRES

KRYETARI

Anisa Jakllari

UJËSJELLËS KANALIZIME
RAJONI DURRËS

Adresa:L.17.Rr.Dalip Peza **e-mail: infoshrukd @ukdurres.al**

CamScanner

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE
UJËSJELLËS KANALIZIME DURRËS SH.A.
KËSHILLI MBIKQYRËS

Nr. 837/5 Prot.

Durrës, më 26.02.2026

VENDIM

Nr. 3. Datë 26. 02. 2026

"PËR

" MIRATIMIN E TARIFAVE TË FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIMEVE PËR PLAN BIZNESIN 2027-2031"

Këshilli Mbikqyres pasi mori në shqyrtim propozimin e paraqitur nga Administratori i Shoqërisë Rajonale U.K.Durrës sha, me nr 837/2 prot, dt 18.02.2026 ; Ne mbështetje të nenit 167 të Ligjit Nr 9901, datë 14.04.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Ligjit nr.10296 date 08.07.2010 "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin", dhe udhezimit vijues te tij nr 30 date 27.12.2011, VKM-ne nr 302 datë 11.05.2022 "Për Politikat Kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura „ neni 13 te Statutit të Shoqërisë;

V e n d o s i:

1. Të konfirmojë dhe miratojë tarifat e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve për Plan Biznesin 2027-2031 sipas tabelës bashkëlidhur.

2. Në vijim të këtij miratimi ngarkohet Administratori të ndjekë të gjitha procedurat e parashikuara ligjore për miratimin e Plan Biznesit dhe realizimin e Seancave dëgjimore me publikun, marrjen e mendimit të Këshillit Bashkiak dhe paraqitjen e aplikimit për miratimin e tarifave pranë ERRU.

KËSHILLI MBIKQYRËS

Znj. Anisa Jakllari	**Kryetar**
Znj. Juna Pali	**Anëtar**
Znj.Almiva Llaçi	**Anëtar**
Z.Aranit Gelaj	**Anëtar**
Z.Adrian Malaj	**Anëtar**

UJËSJELLËS KANALIZIME RAJONI DURRËS

Adresa:L.17.Rr.Dalip Peza e-mail: infoshrukd@ukdurres.al

CamScanner

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE
UJËSJELLËS KANALIZIME DURRËS SH.A.
KËSHILLI MBIKQYRËS

Nr. 3020/4 Prot.

Durrës, më 19.05.2026

VENDIM

Nr. 9. Datë 19. 05. 2026

" PËR
MIRATIMIN E APLIKIMIT TE TARFIMIT ME BLLOQE PËR SHËRBIMET FUP DHE KUN
PËR SHOQËRINË RAJONALE U.K.DURRËS SHA"

Këshilli Mbikqyrës pasi mori në shqyrtim propozimin e paraqitur nga Administratori i Shoqërisë Rajonale U.K.Durrës sha dhe Bordi i Drejtorëve; Ne mbështetje të nenit 167 të Ligjit Nr 9901, datë 14.04.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Ligjit nr.10296 date 08.07.2010 "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin", dhe udhezimit vijues te tij nr 30 date 27.12.2011, VKM-ne nr 302 datë 11.05.2022 "Për Politikat Kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura „ neni 13 te Statutit të Shoqërisë;

V e n d o s i:

1. Miratimin e Tarifimit me blloqe sipas Metodologjise së ERRU dhe Propozimit të Adinistratorit me nr 3020/4 prot, datë 25.05.2026.
2. Ngarkohet Administratori për dërgimin e vendimit për miratim nga Asambleja.

KËSHILLI MBIKQYRËS

Znj. Anisa Jakllari	Kryetar
Znj. Juna Pali	Anëtar
Znj.Almiva Llaçi	Anëtar
Z. Ortion Dhami	Anëtar
Z.Adrian Malaj	Anëtar

CamScanner

RELACION SHPJEGUES TEKNIKO EKONOMIK

PER NJESINE OPERATIVE

RROGOZHINE

Të procesit të aplikimit për tarifa për Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës (SHRUKD)

UJËSJELLËS KANALIZIME
RAJONI DURRËS

Adresa:L.17.Rr.Dalip Peza e-mail: infoshrukd@ukdurres.al

CamScanner

1. Përmbledhje Ekzekutive

Ky realcion shpjegues i ofron Këshillit Bashkiak një pasqyrë të konsoliduar të procesit të ardhshëm të aplikimit për tarifa për Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës (SHRUKD), duke mbuluar ciklin rregullator përtej vitit 2026. Materiali integron supozimet kryesore dhe projeksionet financiare që mbështesin si Planin e Biznesit 5-Vjeçar (2027–2031) hartuar në mbështetje të projekti të AFD-së Konsulenca Institucionale, ashtu edhe dosjen e aplikimit për tarifa në përputhje me kërkesat e ERRU-së, e cila duhet të dorëzohet jo më vonë se data 30 qershor 2026, duke qenë se vendimi aktual për tarifat (Vendimi i ERRU-s Nr. 15, datë 16 maj 2024) skadon më 31 dhjetor 2026.

Propozimi tarifor përfaqëson, për rrjedhojë, një hap kritik drejt përmirësimit të mbulimit të kostove, reduktimit të varësisë nga transfertat dhe forcimit të qëndrueshmërisë afatgjatë, në përputhje të plotë me strategjinë kombëtare të financimit 3T (Taksat–Transfertat–Tarifat) dhe objektivat e Strategjisë Kombëtare të Ujit dhe Kanalizimeve (SKUK 2022–2030).

Në vijim të këtij dokumenti paraqitet një analizë e përmbledhur e performancës operative dhe financiare të shoqërisë, duke marrë vitin 2025 si vit bazë të rakorduar sipas bilancit të mbyllur dhe duke analizuar projeksionet për periudhën tarifore 2027–2029. Kjo periudhë është zgjedhur në përputhje me kërkesat e ERRU-së për aplikimin e ardhshëm tarifor dhe përfaqëson horizontin kohor mbi të cilin do të vlerësohet ndikimi i masave operative, investimeve dhe ndryshimeve tarifore të propozuara. Analiza synon të ilustrojë evolucionin e kostove, të ardhurave, treguesve të mbulimit të kostove dhe nevojave për investime, duke evidentuar arsyetimin financiar dhe operacional që mbështet propozimin tarifor.

Propozimi tarifor për periudhën 2027–2029 për Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës (SHRUKD) përfaqëson një hap të domosdoshëm drejt garantimit të vazhdimësisë së shërbimit, përmirësimit të qëndrueshmërisë financiare dhe reduktimit gradual të varësisë nga subvencionet publike. Analiza tregon se tarifat aktuale nuk mbulojnë plotësisht kostot operative të shoqërisë, duke rezultuar në një nivel mbulimi prej vetëm 85% në vitin 2025. Pa ndërhyrje tarifore, kjo situatë do të kufizonte aftësinë e shoqërisë për të financuar energjinë elektrike, mirëmbajtjen, personelin dhe aktivitetet e nevojshme operative.

Plani i propozuar është ndërtuar mbi parime konservatore dhe realiste. Ai nuk mbështetet në kursime të supozuara nga investime të ardhshme, nuk parashikon ulje agresive të kostove dhe nuk përfshin rikuperimin e investimeve kapitale. Objektivi i tij është ekskluzivisht mbulimi i kostove operative (OPEX), duke krijuar bazën financiare të nevojshme për funksionimin normal të shoqërisë.

Parashikimet tregojnë se gjatë periudhës së planifikimit numri i klientëve aktivë, volumi i ujit të faturuar dhe shërbimet e kanalizimeve do të vazhdojnë të rriten. Konsumi total i ujit pritet të rritet nga rreth 13.6 milion m³ në vitin 2025 në mbi 17 milion m³ në vitin 2029, ndërsa volumi i kanalizimeve nga 8.1 milion m³ në mbi 10.7 milion m³. Kjo rritje mbështetet kryesisht nga zgjerimi i bazës së klientëve, zhvillimi urban dhe turistik në Durrës dhe Kavajë, si dhe nga zgjerimi gradual i mbulimit të shërbimit të kanalizimeve.

Në të njëjtën kohë, kostot operative parashikohen të rriten nga 2.15 miliard lekë në vitin 2025 në rreth 2.49 miliard lekë në vitin 2029. Rritja lidhet kryesisht me energjinë elektrike, pagat, materialet dhe mirëmbajtjen e aseteve. Megjithatë, ritmi i rritjes së kostove mbetet dukshëm më i ulët se ritmi i rritjes së volumit të shërbimeve, duke treguar përmirësim gradual të eficiencës operative.

CamScanner

Konsumi i ujit
(+12.1%), duke
klientëve në Du
Konsumi total

Si rezultat i strategjisë tarifore të propozuar, mbulimi i kostove operative përmirësohet ndjeshëm:

- 85% në vitin 2025
- 102% në vitin 2027
- 105% në vitin 2028
- 108% në vitin 2029

Kjo do të thotë se shoqëria kalon nga një situatë me deficit operacional në një pozicion ku kostot operative mbulohen plotësisht dhe krijohet një rezervë e moderuar financiare për përballimin e risqeve operative.

Analiza sipas njësive operative tregon se:

- **Durrësi**, që përfaqëson mbi 75% të aktivitetit të shoqërisë, arrin mbulimin e plotë të kostove operative brenda periudhës tarifore.
- **Kavaja** paraqet potencialin më të lartë të rritjes, e mbështetur nga zhvillimi i fortë turistik dhe zgjerimi i bazës së klientëve.
- **Kruja** mbetet njësia me sfidat më të mëdha financiare për shkak të bazës së kufizuar të klientëve dhe kostove fikse relativisht të larta.
- **Rrogozhina** vazhdon të kontribuojë pozitivisht në ekuilibrin financiar të shoqërisë, ndonëse rezultatet duhet të interpretohen në kuadër të modelit rajonal të alokimit të kostove.

Nga këndvështrimi social, propozimi tarifor mbetet plotësisht i përballueshëm. Edhe pas rritjeve të propozuara, pesha e faturës së ujësjellës-kanalizimeve ndaj të ardhurave familjare mbetet:

- 2.9% në Durrës–Shijak
- 2.1–2.2% në Kavajë
- 1.9–2.0% në Krujë dhe Rrogozhinë

Këto nivele mbeten dukshëm brenda kufijve të pranueshëm të përballueshmërisë sipas praktikave rregullatore dhe ndërkombëtare.

Në përfundim, propozimi tarifor nuk synon gjenerimin e fitimit, por krijimin e kushteve minimale financiare për operimin normal të sistemit. Ai përfaqëson hapin e parë të domosdoshëm drejt qëndrueshmërisë financiare të SHRUKD, garantimit të cilësisë së shërbimit, ruajtjes së infrastrukturës ekzistuese dhe krijimit të një baze të besueshme për investimet e ardhshme në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve.

1.1 Parashikimet e Planit të Biznesit dhe Zhvillimi i Shërbimit (2025–2031)

Modeli tarifor mbështetet në periudhën bazë zyrtare (rezultatet e vlerësuara për vitin 2025 dhe buxheti i miratuar për vitin 2026) dhe shtrihet përgjatë horizontit të Planit të Biznesit (2027–2031) përmes projeksioneve realiste afatgjata.

Numri total i klientëve rritet nga 140,502 në vitin 2025 në 144,525 në vitin 2026 dhe më tej në 149,717 deri në vitin 2029, ndërsa klientët aktivë (pa klientët joaktivë 51,984) rriten nga 88,518 në 92,541 dhe arrijnë në 97,733 deri në vitin 2029, duke reflektuar konsolidim gradual dhe përmirësim të normave të aktivizimit në të gjitha zonat e shërbimit.

CamScanner

Konsumi i ujit për familjarët rritet nga 10.71 milion m³ në vitin 2025 në 12.01 milion m³ në vitin 2026 (+12.1%), duke arritur në 13.23 milion m³ deri në vitin 2029, i nxitur kryesisht nga rritja e numrit të klientëve në Durrës dhe Kavajë, dhe jo nga rritja e kërkesës për frymë.

Konsumi total i faturuar i ujit (për të gjitha kategoritë e klientëve, përfshirë familjarët, bizneset dhe institucionet publike) rritet nga 13.55 milion m³ në vitin 2025 në 15.70 milion m³ në vitin 2026 (+15.9%), dhe më tej në 17.01 milion m³ deri në vitin 2029, me rritje të moderuar dhe të qëndrueshme gjatë periudhës së Planit të Biznesit.

PËRMBLEDHJE TOTALE - TË GJITHA ZONAT (Durrës-Shijak+Kavajë+Krujë+Rrogozhinë)

KONSUMI TOTAL (m³/vit)	2025	2026	2027	2028	2029	Ndryshimi 2025-2029	% Ndryshi
Klientë Familjarë	10,711,799	12,006,029	12,629,968	12,842,669	13,229,066	2,517,267	23%
Klientë Privatë	2,264,572	3,088,869	2,936,591	3,064,196	3,139,800	875,228	39%
Klientë Publikë	576,063	607,779	629,642	639,936	640,316	64,253	11%
TOTAL GJITHSEJ	**13,552,434**	**15,702,677**	**16,196,201**	**16,546,800**	**17,009,182**	**3,456,748**	**26%**

	2025	2026	2027	2028	2029	Ndryshimi 2025-2029	% Ndryshi m
Klientë Familjarë	129,591	133,500	134,912	135,510	138,260	8,669	7%
Klientë Privatë	10,440	10,554	10,680	10,839	10,998	558	5%
Klientë Publikë	471	471	458	459	459	-12	-3%
TOTAL GJITHSEJ	**140,502**	**144,525**	**146,050**	**146,808**	**149,717**	**9,215**	**7%**

SHËNIM: Klientët joaktivë (51,984 faturohen vetëm me tarifë shërbimi (pa konsum). Numri i klientëve joaktivë mbetet konstant gjatë viteve.

Njesia Operative Durrës dominon tregun me 78% të konsumit total (10.54 milion m³) dhe 72% të numrit të klientëve (101,703), duke qenë zona kryesore e shërbimit të shoqërisë rajonale. Durrësi mban barrën kryesore të të ardhurave, duke kontribuar pjesën më të madhe të qarkullimit financiar të shoqërisë.

Njesia Operative Kavajë përfaqëson 14% të konsumit (1.87 milion m³) dhe 19% të klientëve (26,630), duke treguar potencial të rëndësishëm për zgjerim të shërbimit.

Njësitë e vogla (Rrogozhina dhe Kruja) kontribuojnë së bashku vetëm 8% të konsumit dhe 9% të klientëve, por paraqesin mundësi për përmirësim të efiçencës operative dhe rritje të mbulimit të shërbimit.

KRAHASIMI I ZONAVE - PESHA NË TOTAL (2025)

ZONA	Konsumi 2025	% në Total	Klientë 2025	% në Total
Zona A - Durrës	10,543,163	78%	101,703	72%
Zona B - Kavajë	1,871,899	14%	26,630	19%
Zona C - Rrogozhina	440,973	3%	5,838	4%
Zona C - Kruja	696,399	5%	6,331	5%
TOTAL	**13,552,434**	**100%**	**140,502**	**100%**

Ndërkohe modeli tarifor për shërbimet e kanalizimeve mbështetet në periudhën bazë zyrtare (rezultatet e vlerësuara për vitin 2025 dhe buxheti i miratuar për vitin 2026) dhe shtrihet përgjatë horizontit të Planit të Biznesit (2027–2029) përmes projeksioneve realiste afatgjata.

Numri total i klientëve të kanalizimeve rritet nga 92,003 në vitin 2025 në 95,250 në vitin 2026 dhe më tej në 105,981 deri në vitin 2029, ndërsa klientët aktivë (pa klientët joaktivë 32,000) rriten nga 60,003

CamScanner

Shërbimi i grumbu
në bashkitë Durrës,
Shërbimi i trajtimit
turistike Gjiri Lalzit

në 63,250 dhe arrijnë në 73,981 deri në vitin 2029, duke reflektuar zgjerimin e rrjetit të kanalizimeve dhe rritjen e lidhejve të reja në të gjitha zonat e shërbimit.

Vëllimi i kanalizimeve për familjarët rritet nga 5.86 milion m³ në vitin 2025 në 6.50 milion m³ në vitin 2026 (+10.9%), duke arritur në 7.66 milion m³ deri në vitin 2029, i nxitur kryesisht nga zgjerimi i infrastrukturës në Durrës dhe Kavajë.

Vëllimi total i faturuar i kanalizimeve (për të gjitha kategoritë e klientëve, përfshirë familjarët, bizneset dhe institucionet publike) rritet nga 8.06 milion m³ në vitin 2025 në 9.22 milion m³ në vitin 2026 (+14.4%), dhe më tej në 10.73 milion m³ deri në vitin 2029, me rritje të qëndrueshme gjatë periudhës së Planit të Biznesit.

PËRMBLEDHJE TOTALE KANALIZIME - TË GJITHA ZONAT (Durrës-Shijak+Kavajë+Krujë+Rrogozhinë)

VËLLIMET KANALIZIME TOTAL (m³/vit)	2025	2026	2027	2028	2029	Ndryshimi 2025-2029	% Ndryshim
Klientë Familjarë	5,860,745	6,500,374	6,774,213	6,923,148	7,656,888	1,796,143	31%
Klientë Privatë	1,710,083	2,165,956	2,213,854	2,333,875	2,439,161	729,078	43%
Klientë Publikë	486,989	552,536	568,654	605,504	629,237	142,248	29%
TOTAL GJITHSEJ	**8,057,817**	**9,218,866**	**9,556,722**	**9,862,527**	**10,725,287**	**2,667,470**	**33%**

KLIENTË KANALIZIME TOTAL (numër)	2025	2026	2027	2028	2029	Ndryshimi 2025-2029	% Ndryshim
Klientë Familjarë	83,149	86,133	88,361	91,233	95,697	12,548	15%
Klientë Privatë	8,581	8,843	9,137	9,569	9,977	1,396	16%
Klientë Publikë	273	274	279	294	308	35	13%
TOTAL GJITHSEJ	**92,003**	**95,250**	**97,778**	**101,096**	**105,981**	**13,973**	**15%**

SHËNIM: Klientët joaktivë total (32,000) faturohen vetëm me tarifë shërbimi (pa konsum). Numri mbetet konstant 2025-2029.

2. Përmbledhje për Propozimin për Aplikimin Tarifor

Niveli tarifor për shërbimin e ujit të pijshëm dhe të përdorur që janë aktualisht në fuqi janë miratuar nga ERRU sipas vendimit te datës 16.05.2023 dhe aplikuar nga shoqëria mbas këtij miratimi. Ato hynë në fuqi më 15.06.202 dhe janë te vlefshme deri 31.12.2026.
Aplikimi për ndryshim të nivelit tarifor mbështet në disa dokumenta të cilat shqyrtohen dhe analizohen nga vetë komisioni ERRU-së. Miratimi i ndryshimit të tarifave në thelb mundëson përmirësimin e performancës financiare të shoqërisë, që ndikon në arritjen e rikuperimit të kostove si dhe në rritjen e aftësisë paguese që të mund të likujdojmë detyrimet ndaj kredive.

2.1 Përmbledhje Tregues Teknik

Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës mbulon pellgun hidrografik përkatësisht burimet e furnizimit me ujë: Fushë Kuqe, Fushë Milot, Çerme, Rromanat, Harizaj, Fushë Krujë dhe Kruje, duke patur akses të plotë dhe menaxhim të integruar të këtyre burimeve. Peshën më të madhe në shkallë prodhimi aktualisht e menaxhon Njësia Durrës dhe Shijak, me numër me të madh konsumatorësh gjithashtu. Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Durrës operon në zonën e shërbimit në bashkitë: Durrës, Shijak, Kavajë, Krujë dhe Rrogozhinë.
Shërbimi i furnizimit me ujë ofrohet në zonat urbane dhe rurale të secilës bashki, duke prejashtuar disa fshatra ku nuk ofrohet shërbimi.

CamScanner

Shërbimi i grumbullimit të ujrave të ndotura ofrohet në zonat urbane dhe pjesërisht në disa fshatra në bashkitë Durrës, Kavajë dhe Rrogozhinë.

Shërbimi i trajtimit të ujrave të ndotura ofrohet/planifikohet të ofrohet në: qytet Durrës dhe zonën turistike Gjiri Lalzit aktualisht 2 impiante, qyteti Kavajë me impiant që aktualisht nuk është në funksion, zona turistike Spille me investim në proces për ndërtimin e impiantit.

Njësia Operative Rrogozhinë

Shërbimin e furnizimit me ujë Shërbimin e furnizimit me ujë Njësia Rrogozhinë e ofron nga 5 burime kryesore me anë të të cilave furnizohet me ujë Bashkia Kavajë, pjesërisht Lushnja dhe Rrogozhina, përkatësisht:

- Burimi Kryevidh, me kapacitet 11 l/sek
- Burimi Lekaj, me kapacitet 14 l/sek
- Burimi Gose, me kapacitet 28 l/sek
- Burimi Sinballaj, me kapacitet 6 l/sek
- Burimi Cerme, me kapacitet 10 l/sek

Burimi Kryevidh, ka dy Puse me vendndodhje Greth i Madh dhe Greth i Mesem. Pusi Greth i madh nëpërmjet një tubacioni Ø140 e dërgon ujin në depon 500m^3, e cila furnizon me uje fshatrat Sterbeg, Sharredushk, Spanesh dhe Kazia. Nga ky burim merr uje dhe depo Palk 30m^3 dhe depo Milot 30m^3 me kordinata, të cilat janë lidhur në tubacionin Ø140 PE nëpërmjet tubave 2" xingato. Burimi i ujit Greth i Madh ka nje thellesi 250m me diameter pusi Ø300 ku eshte e instaluar nje pompe me fuqi 30kë.Pusi Greth i Mesem furnizon uje nga depon 90m^3 e cila furnizon fshaterat Spille, Greth i Mesem dhe Greth i Madh. Ky pus me kuote 9m thellesi 250m dhe diameter pusi Ø250mm ne te cilen eshte e insataluar nje pompe zhytese.

Burimi Lekaj, ka dy stacione pompimi:
Stacioni i pompimit Lekaj, me nje pus shpimi me thellesi 265m dhe diameter Ø300mm ku eshte e instaluar nje pompe zhytese 15kë, prej nga ku furnizohet me uje depo grumbulluese 15m3 dhe tre pompa te cilat furnizojne:
Pompa Nr.1 furnizon depon 120 m3 e cila furnizon fshatrat German, Zambish, Mushnik, Karresh, Okshtun dhe lagjen Dedej te fshatit Lekaj.
Pompa Nr.2 furnizon depon 20m3 e cila furnizon fshatin Kukaj
Pompa Nr.3 furnizon depon 100m3 e cila furnizon fshatin Lekaj
Stacioni i pompimit ne Harizaj, me dy pus shpime te cilet furnizojne me uje depon qendrore 500m^3 ne fshatin Harizaj, prej nga ku marrin uje fshatrat Harizaj, Luz i Vogel , Luz i Madh, Shkozet , Beden dhe Çurum.

Burimi Gose, 4 pus shpime duke furnizuar si me poshte vijon:
Fshati Gosë e Vogel furnizohen me uje nga pus shpimi ne Gose te Vogel (pus me thellesi 240m me diameter Ø300mm) ku eshte instaluar nje pompe zhytese , prej nga ku uji grumbullohet në depon 150m3 ne Gose te Vogel dhe furnizon me uje: Gose Qender, Gose e Vogel, Gose e Madhe, Kalush dhe Kërçukaj.
Fshati Vile Bashtove furnizohet me uje nepermjet dy burimeve, Pusi Nr.1 dhe Pusi Nr.2 në nje distance rreth 50m nga njeri tjetri, të cilët furnizojnë me uje depo 90m^3 të fshatit.

CamScanner

Konsumi privat para
ndërsa konsumi pub

Numri total i klientë
5,838 në vitin 2025 n

Fshati Vilë Ballaj, Zeshtik, Zhabjak furnizohen me uje nga pus shpimi ne Ballaj , prej nga ku uji grumbullohet në depon 90m³ qe ndodhet ne lagjen e siperme Çameria dhe furnizon me uje: Ballaj Vendas , Zeshtik, Zhabiak dhe depon 50 m³ në Ballaj i Ri e cila furnizon me uje fshatin Vilë Ballaj.

Burimi Sineballaj, me 2 pus shpime përkatesisht:

Sineballaj e poshteme furnizohet nga pusi Nr.1 me stacion pompimi me ane të depos Nr.1 (200m³), thellesia e pusit eshte 150m dhe diameter Ø160mm.

Sineballaj i siperme furnizohet pusi Nr.2 me stacion pompimi me ane të depos Nr.2 (100m³) .

Sistemet e furnizimit me ujë: rezervuarët dhe rrjeti shpërndarës

Në të gjithë zonën e shërbimit të Njësisë Rrogozhinë kemi 23 Depo uji me kapacitet total grumbullimi prej rreth 4900 m3.

Gjatësia totale e rrjetit kryesor nga burimet deri në depo/rezervuarët është 23 km, ndërsa gjatësia totale e rrjetit shpërndarës është 91 km.

Gjatësia totale e tubacionit të ujit (rrjet kryesor + rrjet shpërndarës) 114 km, nga të cilat 20 km tubacion çeliku, 7 km tubacion gize, 83 km tubacion PVC/PE dhe 4 materiale te tjera.

Si pjesë e investimeve realizuar nga Bashkia Rrogozhinë gjatë viteve 2021-2022 është rikonstrukuar rreth **100%** e rrjetit i furnizimit me ujë të qytetit. Aktualisht zona furnizohet me ujë 24 orë duke ofruar shërbim me sasi dhe cilësi për qytetin.

Sistemet e grumbullimit dhe trajtimit të ujrave të ndotura

Sistemi i kanalizimeve shtrihen pjesërisht në teritorin e Bashkisë Rrogozhinë, në zonën e qytetit vetëm 30% mbulohet me këtë shërbim, ndërsa zonat rurale nuk kanë rrjet kananalizimi. Zona bregdetare e Spillesë është gjithashtu pa rrjet kanalizimi.

Të gjithë ujrat e ndotura të grumbulluara shkarkohen me veterrjedhje nëpër kanale të hapura dhe më pas në lumin Shkumbin.

Gjatësia totale e tubacioneve të kanalizimeve është rreth 22 km. Diametri i kolektoreve është 800 mm, diametrat e rrjetit sekondare varjojne nga 200 mm ÷ 315 mm.

2.2 Klientët dhe Parashikimi i Shitjeve 2025-2029

Njësia Operacionale Rrogozhina përfaqëson segmentin më të vogël të aktivitetit operacional të shoqërisë, me karakteristika rurale-urbane. Ngjashëm me Krujën, Rrogozhina nuk ka sezonalitet gjatë verës për shkak të profilit rural dhe mungesës së turizmit bregdetar.

Konsumi total i faturuar parashikohet të mbetet relativisht i qëndrueshëm nga 440,973 m³ në vitin bazë 2025 në 458,762 m³ në vitin 2026 (+4.0%) dhe më tej në 452,282 m³ deri në vitin 2029, me një rritje totale prej vetëm 3% gjatë periudhës, duke reflektuar stabilitetin e bazës së klientëve dhe mungesën e ndikimit sezonal turistik.

Konsumi familjar mbetet komponenti dominues i kërkesës për ujë në Njësinë Operative Rrogozhina, duke lëvizur nga 377,291 m³ në vitin 2025 në 388,270 m³ deri në vitin 2029 (+3%). Rritja e moderuar lidhet me stabilitetin e popullsisë rurale-urbane.

CamScanner

Konsumi privat parashikohet të rritet lehtësisht nga 17,879 m³ në 2025 në 18,285 m³ në 2029 (+2%), ndërsa konsumi publik (institucione) mbetet i qëndrueshëm rreth 45,803–45,727 m³/vit (0%).

Numri total i klientëve të shërbimit të furnizimit me ujë në Njësinë Operative Rrogozhina rritet nga 5,838 në vitin 2025 në 5,918 deri në vitin 2029 (+1%), ndërsa klientët aktivë (pa 2,331 klientë joaktivë) rriten nga 3,507 në 3,587 gjatë të njëjtës periudhë. Numri i klientëve joaktivë (2,331) mbetet konstant gjatë gjithë periudhës.

ZONA C – RROGOZHINA

KONSUMI RROGOZHINA (m³/vit)	2025	2026	2027	2028	2029	Ndryshimi 2025-2029	% Ndryshim
Klientë Familjarë	377,291	397,670	388,179	384,496	388,270	10,979	3%
Klientë Privatë	17,879	18,250	17,996	18,140	18,285	406	2%
Klientë Publikë	45,803	42,842	45,471	45,522	45,727	-76	0%
TOTAL RROGOZHINA	440,973	458,762	451,646	448,158	452,282	11,308	3%

KLIENTË RROGOZHINA (numër)	2025	2026	2027	2028	2029	Ndryshimi 2025-2029	% Ndryshim
Klientë Familjarë	5,496	5,569	5,516	5,541	5,576	80	1%
Klientë Privatë	270	277	270	273	275	5	2%
Klientë Publikë	72	72	67	67	67	-5	-7%
TOTAL RROGOZHINA	5,838	5,917	5,852	5,880	5,918	80	1%

SHËNIM: Klientët joaktivë (2,331) faturohen vetëm me tarifë shërbimi (pa konsum). Numri i klientëve joaktivë mbetet konstant.

Kanalizime

Shërbimet e kanalizimeve në Njësinë Operative Rrogozhina paraqesin dinamikë pozitive të moderuar, me ritme rritjeje më të larta se ujësjellësi.

Vëllimi total i faturuar i kanalizimeve parashikohet të rritet nga 158,122 m³ në vitin 2025 në 175,581 m³ në vitin 2026 (+11.0%) dhe më tej në 183,052 m³ deri në vitin 2029, me një rritje totale prej 16% gjatë periudhës së Planit të Biznesit.

Vëllimi familjar i kanalizimeve rritet nga 114,295 m³ në 2025 në 128,824 m³ në 2029 (+13%), i nxitur nga konsolidimi i rrjetit ekzistues të kanalizimeve.

Vëllimi privat parashikohet të rritet nga 7,290 m³ në 2025 në 8,749 m³ në 2029 (+20%), ndërsa vëllimi publik (institucione) rritet nga 36,537 m³ në 45,479 m³ (+24%).

Numri total i klientëve të kanalizimeve rritet nga 1,425 në vitin 2025 në 1,491 deri në vitin 2029 (+5%), ndërsa klientët aktivë (pa 750 klientë joaktivë) rriten nga 675 në 741 gjatë të njëjtës periudhë.

CamScanner

KANALIZIME - RROGOZHINA

VËLLIMET KANALIZIME (m³/vit)	2025	2026	2027	2028	2029	Ndryshimi 2025-2029	% Ndryshimi
Klientë Familjarë	114,295	125,915	124,716	126,564	128,824	14,528	13%
Klientë Privatë	7,290	7,624	8,600	8,675	8,749	1,459	20%
Klientë Publikë	36,537	42,042	41,039	43,419	45,479	8,942	24%
TOTAL RROGOZHINA	158,122	175,581	174,355	178,658	183,052	24,929	16%

KLIENTË KANALIZIME (numër)	2025	2026	2027	2028	2029	Ndryshimi 2025-2029	% Ndryshimi
Klientë Familjarë	1,272	1,291	1,282	1,296	1,314	41	3%
Klientë Privatë	135	138	156	157	159	23	17%
Klientë Publikë	17	17	17	18	19	1	8%
TOTAL RROGOZHINA	1,425	1,447	1,455	1,471	1,491	66	5%

SHËNIM: Klientët joaktivë (750) faturohen vetëm me tarifë shërbimi (pa konsum). Numri mbetet konstant 2025-2029.

Segmenti më i vogël: Rrogozhina kontribuon vetëm 3-4% të konsumit të ujit dhe 2% të vëllimit të kanalizimeve - segmenti më i vogël në shoqëri.

Stabilitet operacional: Rritje e moderuar e konsumit (+3% ujësjellës, +16% kanalizime), duke reflektuar qëndrueshmërinë e bazës së klientëve rurale.

Mungesë sezonaliteti: Ngjashëm me Krujën, Rrogozhina nuk ka ndikim turistik sezonal gjatë verës, çka lejon planifikim të thjeshtë.

Potencial në kanalizime: Rritja e kanalizimeve (+16%) tejkalon atë të ujësjellësit (+3%), duke treguar zgjerim të shërbimit.

Përfundim: Rrogozhina paraqet stabilitet operacional me rritje minimale, pa ndikim të turizmit sezonal gjatë verës. Me profilin rural-urban zona karakterizohet nga konsum i qëndrueshëm dhe i parashikueshëm gjatë gjithë vitit.

2.3 Analiza e Shpenzimeve Operative 2025–2029

Struktura e shpenzimeve operative të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës gjatë periudhës 2025–2029 mbetet e dominuar nga dy zërat kryesorë, energjia elektrike dhe pagat, të cilët së bashku përfaqësojnë mbi 75% të kostove totale operative. Projeksionet janë ndërtuar mbi të dhënat e vitit bazë 2025, të rakorduara sipas bilancit të mbyllur, duke reflektuar njëkohësisht objektivat e eficiencës operative, zhvillimet e pritshme të tregut të punës dhe tendencat reale të çmimeve.

Struktura dhe Evolucioni i Përgjithshëm i Kostove

Brenda supozimeve të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës, shpenzimet totale të Shoqërisë Rajonale UKDK parashikohen të rriten nga **2.15 miliard lekë** në vitin 2025 në **2.43 miliard lekë** në vitin 2027, duke reflektuar konsolidimin e operacioneve, rritjen e volumit të shërbimit dhe nevojat në rritje për mirëmbajtje dhe mbështetje operative. Në vijim, ritmi i rritjes ngadalësohet ndjeshëm, me shpenzimet

CamScanner

që arrijnë **2.49 miliard lekë në vitin 2029**, ose një rritje totale prej rreth **16%** gjatë periudhës së analizuar.

Evolucioni i kostove tregon se pjesa më e madhe e rritjes ndodh në fazën fillestare të planit, ndërsa pas vitit 2027 shoqëria hyn në një periudhë stabilizimi operacional, ku kostot mbahen pothuajse në të njëjtin nivel. Ky trend pasqyron një kombinim të ndikimit të inflacionit, zgjerimit të shërbimit dhe investimeve të nevojshme për përmirësimin e performancës teknike, të balancuara nga masat e eficiencës operative dhe kontrollit të kostove.

Faktorët Kryesorë të Kostos

Komponentët kryesorë që ndikojnë strukturën e shpenzimeve gjatë periudhës 2025–2029 mbeten:

- **Shpenzimet për energji elektrike**, të cilat vijojnë të përbëjnë zërin dominues të kostove operative për shkak të karakterit energji-intensiv të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura.
- **Shpenzimet për paga dhe personel**, të cilat mbeten ndër zërat kryesorë të buxhetit, duke reflektuar nevojën për ruajtjen e kapaciteteve operative dhe teknike të shoqërisë.
- **Shpenzimet për materiale, karburant dhe kimikate**, të cilat rriten gradualisht në përputhje me zgjerimin e aktivitetit dhe kërkesat operative.
- **Riparimet dhe mirëmbajtja**, të cilat parashikohen të kenë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm për të garantuar qëndrueshmërinë e aseteve dhe për të reduktuar kostot afatgjata të ndërhyrjeve emergjente.
- **Shpenzimet administrative dhe të shitjes**, të cilat mbeten të kontrolluara dhe rriten në përputhje me zgjerimin e aktivitetit dhe përmirësimin e shërbimit ndaj klientit.

Në tërësi, struktura e kostove tregon një qasje të kujdesshme financiare, ku rritja e shpenzimeve mbështet objektivat operative dhe investuese të shoqërisë, duke ruajtur njëkohësisht stabilitetin financiar dhe parashikueshmërinë e nevojshme për procesin e miratimit të tarifave.

Energjia elektrike vazhdon të mbetet elementi më i rëndësishëm i kostove operative, duke përfaqësuar rreth 43% të totalit të shpenzimeve në vitin 2025 dhe rreth 38% në fund të periudhës së planifikimit. Edhe pse gjatë periudhës janë parashikuar investime të rëndësishme në infrastrukturë, në përputhje me orientimet e Këshillit Mbikëqyrës nuk janë reflektuar paraprakisht kursime nga eficienca energjetike përpara realizimit efektiv të investimeve. Për këtë arsye, konsumi specifik i energjisë mbetet kryesisht në nivelet historike, ndërsa luhatjet e kostove reflektojnë kryesisht ndryshimet në volumet e prodhimit, normat e humbjeve dhe pritshmëritë reale të çmimeve të energjisë në treg. Në terma absolutë, shpenzimet për energji mbeten relativisht të qëndrueshme gjatë gjithë horizontit të planifikimit.

Shpenzimet për personelin përfaqësojnë zërin e dytë më të madh të kostove operative dhe parashikohen të rriten nga rreth ALL 846 milion në vitin 2025 në mbi ALL 1 miliard gjatë periudhës 2027–2029. Kjo rritje nuk lidhet me zgjerimin e stafit, por përkundrazi ndodh paralelisht me një proces gradual racionalizimi të burimeve njerëzore. Sipas skenarit të miratuar, numri i punonjësve reduktohet me rreth 120 punonjës përgjatë tre viteve të ardhshme, duke reflektuar një qasje graduale dhe realiste ndaj optimizimit të strukturës organizative. Megjithatë, efekti i këtij reduktimi kompensohet pjesërisht nga rritja e pagës minimale dhe rritja e pagës mesatare në ekonomi, në përputhje me politikat dhe orientimet e qeverisë për vitet 2027–2029, si dhe nga nevoja për të ruajtur dhe tërhequr personel të kualifikuar në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve. Për rrjedhojë, kostoja mesatare për punonjës rritet, ndërsa procesi i reduktimit të stafit realizohet pa krijuar goditje të menjëhershme operative.

CamScanner

Shpenzimet për riparime dhe mirëmbajtje paraqesin një nga kategoritë me rritjen më të lartë relative gjatë periudhës së planifikimit. Rritja prej rreth 66% krahasuar me vitin bazë pasqyron orientimin strategjik për forcimin e programeve të mirëmbajtjes parandaluese dhe korrigjuese, me qëllim mbrojtjen e aseteve ekzistuese dhe përmirësimin e besueshmërisë së shërbimit. Kjo qasje është në përputhje me rekomandimet e Këshillit Mbikëqyrës, i cili ka kërkuar rritje graduale të shpenzimeve operative të mirëmbajtjes për të shmangur degradimin e mëtejshëm të infrastrukturës dhe për të reduktuar kostot e riparimeve emergjente në afatgjatë.

Shpenzimet për materiale shfaqin gjithashtu një rritje të konsiderueshme gjatë periudhës së analizuar, duke reflektuar kombinimin e disa faktorëve. Së pari, zgjerimi i bazës së klientëve dhe rritja e volumit të shërbimeve kërkon përdorim më të madh të materialeve operative dhe teknike. Së dyti, projeksionet përfshijnë ndikimin e inflacionit dhe tendencat reale të rritjes së çmimeve në treg për materialet e ndërtimit, pjesët e këmbimit, pajisjet teknike dhe materialet e konsumit. Së treti, rritja e aktiviteteve të mirëmbajtjes së planifikuar kërkon furnizime shtesë për rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimeve. Si rezultat, ky zë rritet me rreth 69% deri në vitin 2029, duke mbështetur objektivin për ruajtjen dhe përmirësimin gradual të performancës së aseteve.

Në tërësi, struktura e kostove të parashikuara reflekton një qasje konservatore dhe realiste të planifikimit financiar. Supozimet e përdorura nuk mbështeten në kursime të menjëhershme nga investimet apo në ulje agresive të kostove, por në zhvillime të arritshme operative, rritje graduale të eficiencës, racionalizim të kontrolluar të personelit dhe reflektim të tendencave reale të tregut për pagat dhe çmimet. Kjo siguron që projeksionet financiare të mbeten të qëndrueshme dhe të besueshme për procesin e aplikimit tarifor dhe vlerësimin rregullator nga ERRU.

PËRMBLEDHJE E DETAJUAR E SHPENZIMEVE - SHOQËRIA RAJONALE UKDK (2025-2029)

Zërat e Shpenzimeve	2025	2027	2028	2029	Ndryshimi %
Shpenzime për materiale	124,195	190,238	199,777	209,821	69%
Shpenzime për karburant	44,284	46,499	48,824	51,265	16%
Shpenzime për kimikate	14,497	15,075	15,857	16,704	15%
Shpenzime për energji elektrike	936,846	917,845	945,662	941,254	0%
Shpenzime për riparime dhe mirëmbajtje	68,467	111,398	110,657	113,378	66%
Shpenzime shitje	12,230	12,841	13,483	14,157	16%
Shpenzime administrative	61,739	60,086	63,090	66,220	7%
Shpenzime për taksa	44,747	46,869	49,212	51,645	15%
Shpenzime për paga	845,671	1,031,326	1,041,133	1,029,646	22%
TOTAL SHPENZIME	**2,154,376**	**2,431,371**	**2,486,720**	**2,492,911**	**16%**

SHËNIM: Vlerat janë në mijë lekë (000 ALL).

Analiza e Shpenzimeve Operative – Njësia Operative Rrogozhinë (2025–2029)

Njësia Operative Rrogozhinë përfaqëson segmentin më të vogël të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës, duke kontribuar me rreth 2% të shpenzimeve totale operative të shoqërisë gjatë gjithë periudhës së planifikimit. Megjithëse përmasat e saj operative janë të kufizuara krahasuar me njësitë e tjera, Rrogozhina paraqet një profil të qëndrueshëm të konsumit dhe të kërkesës për shërbim. Shpenzimet totale operative parashikohen të rriten nga ALL 44.9 milion në vitin 2025 në ALL 58.0 milion në vitin 2029, ose me rreth 29%, ndërkohë që konsumi i ujit rritet vetëm me rreth 3% dhe volumi i kanalizimeve me rreth 16%. Kjo diferencë tregon se rritja e kostove lidhet kryesisht me faktorë strukturorë dhe institucionalë, më shumë sesa me zgjerimin e kërkesës për shërbim.

CamScanner

Ngjashëm me Krujën, Njësia Operative Rrogozhinë nuk ndikohet nga sezonaliteti turistik dhe paraqet një profil të qëndrueshëm të konsumit gjatë gjithë vitit. Mungesa e flukseve turistike sezonale redukton presionin mbi sistemin dhe krijon kushte më të favorshme për planifikimin e prodhimit, shpërndarjes dhe kostove operative. Për pasojë, nevojat për kapacitete shtesë operacionale apo investime të lidhura me përballimin e pikut sezonal janë minimale.

Shpenzimet për personelin mbeten elementi dominues i strukturës së kostove gjatë gjithë periudhës së planifikimit. Pesha e tyre rritet nga 68% e totalit të shpenzimeve në vitin 2025 në rreth 71% deri në vitin 2029, duke përfaqësuar nivelin më të lartë ndër të gjitha njësitë operative të shoqërisë. Shpenzimet për paga rriten nga ALL 30.4 milion në ALL 41.2 milion gjatë periudhës së analizuar. Kjo rritje lidhet kryesisht me efektet e rritjes së pagës minimale dhe pagës mesatare në ekonomi, si dhe me nevojën për të ruajtur kapacitetet teknike dhe operacionale në një njësi me bazë relativisht të kufizuar klientësh. Struktura e kostove reflekton faktin se në një sistem të vogël, kostot fikse të personelit zënë një peshë shumë më të madhe në raport me volumet e shërbimit të ofruar.

Energjia elektrike mbetet zëri i dytë më i rëndësishëm i kostove operative, por me peshën më të ulët në të gjithë shoqërinë. Shpenzimet për energji rriten nga ALL 6.0 milion në vitin 2025 në ALL 6.5 milion në vitin 2029, ose me vetëm 9%. Si rezultat, pesha e energjisë në totalin e kostove bie gradualisht nga 13% në 11%. Kjo lidhet me stabilitetin e kërkesës, mungesën e zgjerimeve të mëdha të sistemit të pompimit dhe profilin relativisht të thjeshtë operacional të njësisë.

Shpenzimet për materiale paraqesin rritjen më të lartë ndër zërat operativë, duke kaluar nga ALL 2.6 milion në vitin 2025 në ALL 3.9 milion në vitin 2029, ose me rreth 52%. Rritja reflekton nevojën për zëvendësime dhe mirëmbajtje të vazhdueshme të rrjetit ekzistues, si dhe përmirësimin gradual të standardeve operative. Në të njëjtën kohë, shpenzimet për riparime dhe mirëmbajtje rriten me rreth 16%, nga ALL 0.9 milion në ALL 1.1 milion, duke treguar një qasje konservatore të menaxhimit të aseteve dhe mungesë të investimeve të mëdha në zgjerimin e infrastrukturës.

Shpenzimet për karburant, kimikate, taksa dhe administrim paraqesin rritje të moderuara, të lidhura kryesisht me inflacionin dhe rritjen graduale të kostove operative. Struktura e tyre mbetet relativisht e qëndrueshme dhe nuk ushtron presion të konsiderueshëm mbi performancën financiare të njësisë.

Nga këndvështrimi i eficiencës operative, sfida kryesore e Rrogozhinës lidhet me ekonominë e shkallës. Ndërsa konsumet dhe baza e klientëve mbeten pothuajse të pandryshuara, kostot operative rriten ndjeshëm më shpejt. Kostoja për metër kub ujë rritet nga ALL 102/m³ në ALL 128/m³ deri në vitin 2029, ndërsa kostoja për klient rritet me rreth 27%. Kjo tregon se njësia përballet me vështirësi për të shpërndarë kostot fikse mbi një bazë më të gjerë konsumatorësh, duke kufizuar potencialin për përmirësim të eficiencës.

Në përfundim, Njësia Operative Rrogozhinë paraqet profilin më të veçantë brenda shoqërisë rajonale, të karakterizuar nga konsum i qëndrueshëm, mungesë e ndikimit sezonal dhe peshë shumë e lartë e kostove të personelit. Megjithëse kjo krijon stabilitet operacional dhe parashikueshmëri të kostove, rritja e kufizuar e konsumit dhe madhësia e vogël e njësisë e bëjnë më të vështirë përmirësimin e treguesve të eficiencës. Për rrjedhojë, fokusi kryesor gjatë periudhës së planifikimit duhet të mbetet optimizimi i proceseve operative, racionalizimi gradual i kostove dhe ruajtja e cilësisë së shërbimit pa krijuar presione shtesë mbi strukturën financiare të njësisë.

CamScanner

PËRMBLEDHJE SHPENZIMESH - KDO RROGOZHINË (2025-2029)

Zërat e Shpenzimeve	2025	2027	2028	2029	Ndryshimi %
Shpenzime për materiale	2,562	3,530	3,706	3,892	52%
Shpenzime për karburant	888	932	979	1,028	16%
Shpenzime për kimikate	354	372	391	410	16%
Shpenzime për energji elektrike	5,986	6,248	6,373	6,501	9%
Shpenzime për riparime dhe mirëmbajtje	911	957	1,005	1,055	16%
Shpenzime shitje	224	235	247	259	16%
Shpenzime administrative	850	905	951	993	17%
Shpenzime për taksa	813	831	872	916	13%
Shpenzime për paga	30,391	41,253	41,645	41,186	36%
TOTAL SHPENZIME	44,913	56,854	57,819	57,952	29%

SHËNIM: Vlerat janë në mijë lekë (000 ALL). Total = Ujësjellës + Kanalizime.

Përfundime:

Njësia Operative Rrogozhinë mbetet segmenti më i vogël i shoqërisë rajonale, duke përfaqësuar vetëm rreth 2% të shpenzimeve operative totale gjatë gjithë periudhës së planifikimit. Shpenzimet operative rriten nga ALL 44.9 milion në vitin 2025 në ALL 58.0 milion në vitin 2029, ose me rreth 29%.

Njësia karakterizohet nga mungesa e plotë e ndikimit sezonal dhe nga një profil relativisht i qëndrueshëm i konsumit. Megjithatë, madhësia e vogël e sistemit bën që struktura e kostove të dominohet nga kostot fikse të personelit. Shpenzimet për paga përfaqësojnë rreth 68% të totalit në vitin 2025 dhe arrijnë në 71% deri në fund të periudhës së planifikimit, niveli më i lartë në të gjithë shoqërinë.

Energjia elektrike përfaqëson vetëm 13% të kostove totale, duke qenë pesha më e ulët ndër të gjitha njësitë operative. Ndërkohë, shpenzimet për mirëmbajtje rriten me vetëm 16%, duke reflektuar rjetin relativisht të kufizuar dhe nevojat më të ulëta për ndërhyrje infrastrukturore.

Sfida kryesore e Rrogozhinës lidhet me mungesën e ekonomisë së shkallës. Ndërsa konsumi i ujit rritet vetëm me rreth 3%, shpenzimet operative rriten me 29%, duke sjellë rritjen e kostos mesatare për metër kub nga 102 ALL/m³ në 128 ALL/m³. Kjo tregon se njësia përballet me vështirësi në shpërndarjen e kostove fikse mbi një bazë më të gjerë konsumatorësh dhe kërkon optimizim të vazhdueshëm të proceseve operative për të ruajtur qëndrueshmërinë financiare.

Vlerësimi i Përgjithshëm i Këshillit Mbikëqyrës

Në përgjithësi, projeksionet pasqyrojnë udhëzimet kryesore të Këshillit Mbikëqyrës: realizëm mbi optimizëm, gradualizëm mbi përparim të ngarkuar dhe koherencë ndërmjet planifikimit dhe justifikimit të tarifave. Rritja e kërkesës, reduktimi i UPA-së dhe zgjerimi i shërbimeve të ujërave të ndotura janë të ankoruara në të dhënat bazë të miratuara, supozime konservative dhe metodologji në përputhje me ERRU-në, duke siguruar një bazë të fortë dhe të mbrojtshme rregullatore si për Planin e Biznesit ashtu edhe për Shënimin Mbështetës të Aplikimit Tarifor. Ndryshimi i nivelit tarifor sipas Planit të Biznesit është miratuar nga KM me vendimin nr.3 datë 26.02.2026.

CamScanner

Nevojat për të Ardhura, Rikuperimi i Kostove dhe Qëndrueshmëria Tarifore (2027–2029)

Kuadri i shpenzimeve operative për periudhën 2025–2029 siguron bazën e kostove të rregulluara që mbështet projeksionet e Planit të Biznesit dhe aplikimin tarifor në përputhje me ERRU-në. Struktura e kostove bazohet në rezultatet e vlerësuara për vitin 2025 dhe shtrihet përgjatë horizontit të Planit të Biznesit sipas udhëzimeve të qarta të Këshillit Mbikëqyrës, duke kërkuar supozime konservative dhe të zbatueshme.

2.4 Nevojat për të Ardhura dhe Perspektiva e Shlyerjes së Kostove

Të ardhurat për aktivitetet e rregulluara të SHRUKD gjatë periudhës 2027–2029 janë llogaritur në përputhje me metodologjinë tarifore të ERRU-së "Kosto Plus", e cila synon mbulimin e kostove operative të nevojshme për ofrimin e shërbimit. Në këtë kuadër, kërkesa për të ardhura bazohet në kostot operative të rregulluara (OPEX), të përllogaritura sipas parashikimeve të Planit të Biznesit dhe të harmonizuara me supozimet e miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës. Kjo qasje siguron që tarifat e propozuara të mbështesin qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë, të garantojnë vazhdimësinë e shërbimit dhe të jenë në përputhje me kërkesat rregullatore të ERRU-së.

Strukturë e Tarifës dhe Përbërja e të Ardhurave

Modeli i tarifës përdor një strukturë dy-pjesëshe:

- një **tarifë fikse** (raporti i tarifës së shërbimit është rishikuar duke u rritur nga 19% në 24% të kostove direkte operative), duke siguruar stabilitet të të ardhurave për të gjitha kategoritë e klientëve; dhe
- një **tarifë volumetrike**, e lidhur drejtpërdrejt me konsumimin e ujit dhe të ujërave të zeza.

Të ardhurat nga tarifa e shërbimit rriten nga 350.3 milionë lekë në vitin 2025 në 577.9 milionë lekë në vitin 2029, duke reflektuar harmonizimin e strukturës tarifore dhe zgjerimin gradual të bazës së klientëve:

Burimi kryesor i të ardhurave vijon të jetë tarifa volumetrike:

- Të ardhurat nga furnizimi me ujë rriten nga 1.09 miliard lekë në vitin 2025 në 1.49 miliard lekë në vitin 2029, ose rreth 37% gjatë periudhës.
- Të ardhurat nga kanalizimet rriten nga 391.1 milionë lekë në 631.3 milionë lekë, ose rreth 61%, duke reflektuar zgjerimin e mbulimit të shërbimit dhe rritjen e volumit të faturuar.

Kategoria familjare mbetet kontribuesi kryesor në strukturën e të ardhurave, duke gjeneruar 1.26 miliard lekë në vitin 2025 dhe duke arritur në 1.78 miliard lekë në vitin 2029, ose rreth 66% të totalit të të ardhurave tarifore. Klientët privatë kontribuojnë nga 459 milionë lekë në 771 milionë lekë, ndërsa institucionet publike nga 110 milionë lekë në 158 milionë lekë gjatë të njëjtës periudhë.

Si rezultat, të ardhurat totale nga strategjia tarifore rriten nga 1.83 miliard lekë në vitin 2025 në 2.70 miliard lekë në vitin 2029, duke krijuar bazën e nevojshme financiare për mbulimin e kostove operative të shoqërisë.

CamScanner

2029. Funksi
qëndrueshme
Rrogozhinë –
kostove operati

Mbulimi i Nevojave për të Ardhura

Analiza e raportit ndërmjet të ardhurave të parashikuara dhe kostove operative tregon një përmirësim të ndjeshëm të qëndrueshmërisë financiare gjatë periudhës së planifikimit.

Në vitin bazë 2025, të ardhurat tarifore mbulojnë vetëm 85% të kostove operative, duke krijuar një deficit prej 321.3 milionë lekësh. Ky nivel është rezultat i trashëgimisë së tarifave ekzistuese, të cilat nuk reflektojnë më kostot aktuale të operimit të sistemit rajonal.

Me zbatimin e strategjisë së re tarifore, situata përmirësohet ndjeshëm:

- Në vitin 2027, të ardhurat tarifore arrijnë 2.49 miliard lekë, duke tejkaluar nevojën për të ardhura me 58.3 milionë lekë.
- Në vitin 2028, suficiti rritet në 112.7 milionë lekë.
- Në vitin 2029, suficiti arrin në 211.9 milionë lekë.

Kjo tregon se tarifa e propozuar jo vetëm siguron mbulimin e plotë të kostove operative, por krijon edhe një rezervë financiare minimale për të përballuar rreziqet operative, luhatjet e konsumit dhe rritjen e kostove të paparashikuara.

Mbulimi i Kostove Operative dhe Qëndrueshmëria Financiare

Për sa i përket qëndrueshmërisë financiare, treguesi kryesor i performancës, Mbulimi i Kostove Direkte Operative (DOC Coverage), tregon një përmirësim të ndjeshëm gjatë gjithë periudhës së planifikimit. Në vitin 2025, me strukturën aktuale tarifore, të ardhurat e shoqërisë mbulojnë vetëm rreth 85% të kostove operative, duke reflektuar një deficit strukturor që kufizon aftësinë e saj për të financuar plotësisht aktivitetin e përditshëm. Me zbatimin e planit të ri tarifor, ky tregues rritet në 102% në vitin 2027, duke kaluar për herë të parë pragun e mbulimit të plotë të kostove operative. Përmirësimi vijon më tej në 105% në vitin 2028 dhe 108% në vitin 2029, duke krijuar një nivel të arsyeshëm sigurie financiare për përballimin e rreziqeve operative, luhatjeve të kostove dhe nevojave të paparashikuara të sistemit.

Ky rezultat është veçanërisht i rëndësishëm pasi analiza bazohet vetëm në kostot direkte operative (OPEX), në përputhje me metodologjinë aktuale tarifore të ERRU-së "Kosto Plus". Pra, mbulimi mbi 100% nuk nënkupton krijim fitimi apo financim të investimeve kapitale, por garanton që shoqëria të jetë në gjendje të përballojë në mënyrë të qëndrueshme kostot e energjisë elektrike, personelit, materialeve, mirëmbajtjes dhe operimit të sistemeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve.

Rezultatet sipas Njësive Operative

- **Durrës** – Njësia më e madhe e shoqërisë përmirëson ndjeshëm performancën financiare, duke kaluar nga një mbulim i kostove operative prej 85% në vitin 2025 në 102% në vitin 2027. Përmirësimi vazhdon gradualisht në 103% në vitin 2028 dhe 108% në vitin 2029, duke siguruar mbulimin e plotë të kostove operative dhe një nivel të arsyeshëm stabiliteti financiar.
- **Kavajë** – Paraqet një performancë të fortë financiare gjatë gjithë periudhës së planit. Mbulimi i kostove operative rritet nga 92% në vitin 2025 në 112% në vitin 2027, duke arritur 119% në vitin 2028 dhe 123% në vitin 2029. Kjo tregon një kapacitet të qëndrueshëm për të gjeneruar të ardhura mbi nevojat operative.
- **Krujë** – Vijon të mbetet njësia me sfidat më të mëdha financiare për shkak të kostove strukturore më të larta dhe bazës më të kufizuar të klientëve. Megjithatë, treguesi përmirësohet nga 59% në vitin 2025 në 69% në vitin 2027 dhe stabilizohet në rreth 70% gjatë viteve 2028–

CamScanner

2029. Funksionimi në kuadër të modelit rajonal garanton që shërbimi të ofrohet në mënyrë të qëndrueshme edhe në këtë njësi.

- Rrogozhinë – Ruhet si njësia me performancën më të lartë financiare në shoqëri. Mbulimi i kostove operative rritet nga 104% në vitin 2025 në 122% në vitin 2027, duke arritur 126% në vitin 2028 dhe 127% në vitin 2029. Kjo performancë kontribuon pozitivisht në qëndrueshmërinë e përgjithshme të modelit rajonal.
- Në nivel rajonal, treguesi i mbulimit të kostove operative përmirësohet nga 85% në vitin 2025 në 102% në vitin 2027, 105% në vitin 2028 dhe 108% në vitin 2029. Kjo konfirmon se plani tarifor arrin objektivin kryesor të metodologjisë "Kosto Plus", duke siguruar mbulimin e plotë të kostove operative dhe duke krijuar bazën financiare të nevojshme për vazhdimësinë dhe përmirësimin e shërbimit në të katër bashkitë e rajonit.

Tabela 1: Nevojat për të ardhura dhe mbulimi i kostove SHRUKD

Plani i te ardhurave SHRUKD	2025	2027	2028	2029
Te Ardhura				
Tarifa e sherbimit				
Familjar	311,018,400	485,683,200	487,836,000	497,736,000
Privat	37,584,000	76,896,000	78,040,800	79,185,600
Publik	1,695,600	3,297,600	3,304,800	3,304,800
Uje				
Familjar	701,161,806	846,140,748	889,715,091	926,222,710
Privat	313,293,964	440,488,687	459,629,354	470,970,020
Publik	77,255,980	94,446,300	95,990,400	96,047,400
Me shumice				
Kanalizim				
Familjar	251,804,896	303,705,209	317,270,540	351,745,388
Privat	108,444,644	186,877,485	211,084,009	220,666,640
Publik	30,828,521	52,118,746	56,500,361	58,891,046
Te ardhura sipas kategorive				
Familjar	1,263,985,102	1,635,529,157	1,694,821,631	1,775,704,098
Privat	459,322,608	704,262,172	748,754,163	770,822,260
Publik	109,780,101	149,862,646	155,795,561	158,243,246
Te ardhura totale (Strategjia e Tarifave)				
Te ardhurat totale nga strategjia tarifore	1,833,087,810	2,489,653,975	2,599,371,355	2,704,769,604
Nevoja e te ardhurave	2,154,376,000	2,431,371,452	2,486,720,079	2,492,910,945
Mbulimi i nevojave nga te ardhurat	(321,288,190)	[illegible]	[illegible]	[illegible]
Mbulimi i Kostos Direkte-Te ardhurat	85%	102%	105%	108%
Mbulimi i Kostos Direkte-Te ardhurat Durres	85%	102%	103%	108%
Mbulimi i Kostos Direkte-Te ardhurat Kavaja	92%	112%	119%	123%
Mbulimi i Kostos Direkte-Te ardhurat Kruje	59%	69%	70%	70%
Mbulimi i Kostos Direkte-Te ardhurat Rroggozhine	104%	122%	126%	127%

Mbulimi i Kostove Operative dhe Qëndrueshmëria Financiare – Njësia Operative Rrogozhinë

Njësia Operacionale Rrogozhinë paraqet performancën më të mirë financiare ndër njësitë përbërëse të Shoqërisë Rajonale UKD, duke arritur të mbulojë plotësisht kostot operative që në vitin bazë dhe duke ruajtur një pozicion pozitiv gjatë gjithë periudhës së planifikimit. Në vitin 2025, të ardhurat nga strategjia tarifore arrijnë në rreth **46.7 milionë lekë**, ndërsa nevoja për të ardhura e bazuar në kostot operative llogaritet në **44.9 milionë lekë**, duke gjeneruar një suficit prej rreth **1.8 milionë lekësh**. Ky rezultat tregon se njësia arrin të financojë aktivitetin e saj operativ pa krijuar deficit financiar.

Me zbatimin e planit të ri tarifor, performanca financiare përmirësohet më tej. Në vitin 2027, të ardhurat rriten në **69.6 milionë lekë**, kundrejt një nevoje për të ardhura prej **56.9 milionë lekësh**, duke krijuar një suficit prej rreth **12.7 milionë lekësh**. Ky trend vazhdon edhe në vitet 2028 dhe 2029, ku diferenca pozitive ndërmjet të ardhurave dhe kostove operative arrin respektivisht në **15.0 milionë**

CamScanner

lekë dhe 15.7 milionë lekë. Kjo e pozicionon Rrogozhinën si një njësi me kapacitet të lartë për rikuperimin e kostove operative dhe me një kontribut pozitiv në qëndrueshmërinë financiare të modelit rajonal.

Megjithatë, këto rezultate duhet të interpretohen me kujdes. Edhe pse treguesit financiarë paraqesin një nivel mbulimi mbi 100% të kostove operative, duhet pasur parasysh se procesi i alokimit të kostove në nivel njësie operacionale përballet me kufizime praktike dhe metodologjike. Për shkak të organizimit rajonal të shoqërisë, një pjesë e kostove administrative, teknike dhe mbështetëse regjistrohen dhe menaxhohen në nivel qendror, kryesisht në Njësinë Operacionale Durrës, pasi aty ndodhen funksionet kryesore të menaxhimit, administratës, logjistikës dhe mbështetjes teknike.

Si rrjedhojë, jo të gjitha kostot e lidhura me ofrimin e shërbimit në Rrogozhinë mund të ndahen dhe atribuohen me saktësi absolute në nivel njësie. Për këtë arsye, suficiti i paraqitur nuk duhet të konsiderohet si fitim i disponueshëm apo si tregues se njësia operon në mënyrë plotësisht të pavarur financiarisht. Në praktikë, një pjesë e kostove që mbështesin funksionimin e Rrogozhinës përthithen nga strukturat e përbashkëta rajonale dhe pasqyrohen në njësi të tjera, kryesisht në Durrës.

Pavarësisht këtij kufizimi metodologjik, rezultatet mbeten shumë pozitive dhe tregojnë se Rrogozhina disponon një bazë të shëndetshme klientësh, një nivel të mirë të arkëtimit dhe një raport të favorshëm ndërmjet kostove dhe të ardhurave. Kjo e bën njësinë një kontribuues të rëndësishëm në ekuilibrin financiar të shoqërisë rajonale dhe një faktor mbështetës për funksionimin e modelit të solidaritetit ndërmjet njësive.

Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se analiza është ndërtuar vetëm mbi kostot operative (OPEX) dhe nuk përfshin financimin e investimeve kapitale, rinovimin e aseteve apo nevojat afatgjata për modernizimin e infrastrukturës. Në këtë kuptim, performanca e Rrogozhinës demonstron se plani tarifor arrin objektivin kryesor të metodologjisë "Kosto Plus", duke siguruar mbulimin e plotë të kostove operative dhe duke kontribuar në qëndrueshmërinë financiare të të gjithë sistemit rajonal të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve.

Tabela 2 – Nevojat për të ardhura dhe mbulimi i kostove Rrogozhinë

Rrogozhine Plani i te Ardhurave	2025	2027	2028	2029
Te Ardhura				
Tarifa e sherbimit				
Familjar	13,189,200	19,855,800	19,945,800	20,071,800
Privat	973,440	1,946,880	1,963,728	1,980,576
Publik	258,336	479,232	482,976	482,976
Uje				
Familjar	18,109,953	20,185,292	21,147,279	21,354,831
Privat	1,716,402	2,699,340	2,721,028	2,742,717
Publik	4,580,334	6,820,686	6,828,300	6,859,080
Me shumice				
Kanalizim				
Familjar	5,442,640	11,877,706	13,259,133	13,495,804
Privat	1,325,420	3,127,309	3,469,810	3,499,579
Publik	1,141,780	2,564,955	2,985,086	3,126,679
Te ardhura sipas kategorive				
Familjar	36,741,793	51,918,797	54,352,211	54,922,435
Privat	4,015,262	7,773,529	8,154,566	8,222,873
Publik	5,980,450	9,864,873	10,296,362	10,468,735
Te ardhura totale (Strategjia e Tarifave)				
Te ardhurat totale nga strategjia tarifore	46,737,505	69,557,199	72,803,140	73,614,043
Nevoja e te ardhurave	44,912,703	56,854,480	57,819,353	57,952,462
Mbulimi i nevojave nga te ardhurat				

CamScanner

Pikat Krysore **mbi mbulimin e kostove operative sipas njësive operative**

- **Rezultatet në nivel njësie operative duhet të interpretohen në kuadrin e modelit rajonal të operimit.** Për shkak të organizimit të Shoqërisë Rajonale UKD, një pjesë e kostove administrative, teknike, logjistike dhe mbështetëse menaxhohen në nivel qendror dhe regjistrohen kryesisht në Njësinë Operative Durrës, ku ndodhen funksionet kryesore të administrimit dhe menaxhimit të shoqërisë. Si rrjedhojë, ndarja e kostove ndërmjet njësive nuk mund të realizohet me saktësi absolute dhe rezultatet financiare të secilës njësi nuk duhet të interpretohen si tregues të pavarësisë së plotë financiare. Për këtë arsye, suficitet apo deficitet e evidentuara në nivel njësie reflektojnë kryesisht performancën operative relative dhe jo domosdoshmërisht koston e plotë ekonomike të shërbimit në secilin territor.
- **Plani tarifor arrin objektivin kryesor rregullator të ERRU-së**, duke e çuar Shoqërinë Rajonale UKD nga një nivel mbulimi prej 85% të kostove operative në vitin 2025 në mbi 100% që nga viti 2027, duke garantuar mbulimin e plotë të OPEX-it në nivel rajonal.
- **Durrësi përfaqëson pikën kryesore të kthesës financiare të shoqërisë**, duke kaluar nga një deficit prej rreth 256 milionë lekësh në vitin 2025 në një suficit operacional prej mbi 41 milionë lekësh në vitin 2027, i cili rritet në afro 148 milionë lekë deri në vitin 2029.
- **Kavaja konsolidohet si një nga njësitë më të forta financiarisht**, duke kaluar nga një mbulim prej 92% të kostove operative në vitin 2025 në mbi 120% deri në fund të periudhës së planit, duke krijuar një rezervë të qëndrueshme financiare për përballimin e rreziqeve operative.
- **Kruja mbetet njësia me sfidat më të mëdha strukturore**, ku edhe pas rishikimit tarifor mbulimi i kostove operative arrin rreth 70%. Kjo reflekton karakteristikat teknike dhe demografike të zonës dhe jo mungesën e efektivitetit të tarifës, duke evidentuar rëndësinë e modelit rajonal të solidaritetit financiar.
- **Rrogozhina vijon të paraqesë performancën më të mirë financiare**, me të ardhura që tejkalojnë kostot operative gjatë gjithë periudhës së analizuar. Megjithatë, rezultatet duhen interpretuar me kujdes, pasi një pjesë e kostove të përbashkëta administrative dhe teknike alokohen në Durrës për shkak të organizimit rajonal të shoqërisë.
- **Mbulimi mbi 100% nuk përfaqëson fitim**, por krijimin e një hapësire minimale sigurie financiare për të përballuar luhatjet e kostove të energjisë, inflacionin, ndërhyrjet emergjente dhe pasiguritë operative që karakterizojnë sektorin e ujësjellës-kanalizimeve.
- **Analiza bazohet ekskluzivisht në kostot operative (OPEX)** sipas metodologjisë aktuale "Kosto Plus" të ERRU-së. Kjo do të thotë se tarifa e propozuar nuk financon ende rinovimin e aseteve, investimet kapitale apo zgjerimin e infrastrukturës, por përfaqëson hapin e parë dhe të domosdoshëm drejt qëndrueshmërisë financiare afatgjatë të shoqërisë.
- **Modeli rajonal dëshmon vlerën e tij ekonomike**, duke mundësuar që njësitë me performancë më të fortë të mbështesin balancimin e sistemit në tërësi dhe të garantojnë standarde të njëjta shërbimi për qytetarët e Durrësit, Kavajës, Krujës dhe Rrogozhinës.
- Veçanërisht e rëndësishme për Këshillat Bashkiakë është se:
  - **Durrësi**, që përfaqëson pjesën më të madhe të sistemit rajonal, kalon nga deficit operacional në mbulim të plotë të kostove që në vitin 2027.
  - **Kavaja** forcon më tej pozicionin financiar dhe krijon kapacitet shtesë për mirëmbajtje dhe investime.
  - **Rrogozhina** vijon të jetë një njësi me performancë të lartë financiare.
  - **Kruja**, edhe pse mbetet nën nivelin e mbulimit të plotë, përfiton nga modeli rajonal i operimit, i cili garanton ofrimin e shërbimit në të njëjtat standarde për të gjithë qytetarët e rajonit.

CamScanner

Mesazhi Kryesor për Këshillat Bashkiakë

Miratimi i tarifës nuk synon rritjen e fitimit të shoqërisë. Qëllimi është që në vitin 2027 shoqëria të dalë nga një situatë ku mungojnë 321 milionë lekë më vit për të financuar operacionet, në një situatë ku kostot operative mbulohen plotësisht dhe shërbimi bëhet financiarisht i qëndrueshëm.

Pa këtë korrigjim tarifor:

- do të vazhdojë mungesa e fondeve për mirëmbajtjen e rrjetit;
- do të shtohen ndërhyrjet emergjente dhe kostot e avarive;
- do të kufizohet aftësia për të përmirësuar furnizimin me ujë dhe kanalizimet;
- do të rritet varësia nga subvencionet dhe mbështetja e bashkive.

Me miratimin e tarifës, SHRUKD arrin që nga viti 2027 të financojë plotësisht operacionet e saj, të garantojë vazhdimësinë e shërbimit dhe të krijojë bazën financiare të nevojshme për përmirësimin gradual të infrastrukturës në Durrës, Kavajë, Krujë dhe Rrogozhinë.

Rrogozhina paraqet një profil operacional relativisht të balancuar, me volumet e faturuara familjare që mbeten rreth 390–400 mijë m³ në vit dhe konsum biznesi rreth 18 mijë m³. Edhe pse është njësia më e vogël për nga madhësia, ajo karakterizohet nga një raport i favorshëm ndërmjet kostove dhe të ardhurave.

Të ardhurat totale rriten nga 25.3 milion lekë në vitin 2025 në rreth 31 milion lekë në vitin 2029, ndërsa çmimi mesatar rritet nga 55 lekë/m³ në 68–69 lekë/m³. Treguesi i kostos operative neto për m³ përmirësohet nga 78 lekë/m³ në vitin 2025 në mbi 100 lekë/m³ gjatë viteve të planit, duke reflektuar aftësinë e njësisë për të mbuluar kostot operative.

Megjithatë, rezultatet duhet të interpretohen në kontekstin e organizimit rajonal të shoqërisë. Një pjesë e kostove administrative, teknike dhe mbështetëse regjistrohen në nivel qendror, kryesisht në Durrës, për shkak të natyrës së organizimit të shoqërisë. Për këtë arsye, performanca e Rrogozhinës nuk duhet parë si funksionim plotësisht i pavarur financiarisht, por si një tregues i një baze të shëndetshme klientësh dhe i një raporti të favorshëm ndërmjet kostove dhe të ardhurave brenda modelit rajonal. Në këtë kuadër, Rrogozhina mbetet një kontribuues i rëndësishëm në ekuilibrin financiar të të gjithë shoqërisë.

Tabela 3 – Diferenca e kostos me çmimin për m3

Gjendja aktuale pasbilancit UJËSJELLËS 2025	Njësia Operacionale Rrogozhina			
	2025	2027	2028	2029
Kosto Direkte Operative	35,887,136	45,701,208	46,480,376	46,598,438
Kosto e mbuluar nga tarifa e sherbimit	5,916,900	10,756,693	10,940,086	10,967,874
Kosto Direkte Operative- koston e mbuluar nga tarifa e sherbimit	29,970,236	34,944,515	35,540,290	35,630,563
Sasia m3 faturuar	**462,119**	**451,646**	**448,158**	**452,282**
KDO per m3 pa koston e mbuluar nga tarifa e sherbimit	**78**	**101**	**104**	**103**
Te ardhurat totale pa tvsh	25,343,856	29,709,871	30,719,962	30,949,709
Sasia m3 faturuar familjar	397,670	388,179	384,496	388,270
Sasia m3 privat	17,152	17,996	18,140	18,285
Sasia m3 institucione	47,297	45,471	45,522	45,727
Cmimi m3 faturuar familjar	48	52	55	55
Cmimi m3 biznes	100	150	150	150
Cmimi m3 institucione	96	150	150	150
Cmimi tarifa e sherbimit familjar	200	300	300	300
Cmimi tarifa e sherbimit privat/institucion	300	600	600	600
Cmimi mesatar	**55**	**66**	**69**	**68**
Gap I cmimit me koston	**-23**	**-35**	**-35**	**-35**
Rritja te ardhurave ne %		**17%**	**3%**	**1%**

CamScanner

3. Plani i Rregullimit të Tarifave (2027–2029)

Plani i propozuar i rregullimit të tarifave për periudhën 2027–2029 është hartuar në përputhje me metodologjinë tarifore të ERRU-së dhe bazohet në objektivin kryesor të arritjes së mbulimit të plotë të kostove operative (OPEX) të nevojshme për ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve. Struktura tarifore është ndërtuar mbi parimin e rikuperimit gradual dhe të qëndrueshëm të kostove, duke balancuar nevojat financiare të shoqërisë me përballueshmërinë për konsumatorët dhe stabilitetin e tarifave gjatë periudhës rregullatore.

Strategjia e tarifave bazohet në parimet kryesore të mëposhtme:

- Strukturë e integruar e tarifës së vetme, që përfshin furnizimin me ujë, kanalizimet dhe trajtimin e ujërave të zeza, duke siguruar transparencë dhe përputhshmëri rregullatore.
- Strukturë e ekuilibruar fikse–volumetrike, me 24% të tarifës fikse dhe 76% volumetrike, plotësisht në përputhje me plafonin rregullator prej 30% për tarifat fikse dhe dizajnuar për të ruajtur stabilitetin e të ardhurave duke mbajtur incentiva bazuar në konsum.

Ndryshe nga modelet tarifore që synojnë rikuperimin e plotë të kostove ekonomike të shërbimit, përfshirë amortizimin, financimin e investimeve dhe kthimin mbi kapitalin, plani aktual fokusohet ekskluzivisht në mbulimin e kostove operative të lejuara (OPEX). Për këtë arsye, objektivi kryesor i strategjisë tarifore është që shoqëria të kalojë nga një situatë ku të ardhurat nuk mbulojnë plotësisht kostot operative në vitin 2025, në një nivel mbulimi mbi 100% gjatë periudhës 2027–2029.

Rezultatet e modelit tregojnë se kjo qasje mundëson arritjen graduale të qëndrueshmërisë financiare operative, duke siguruar që të ardhurat e gjeneruara nga tarifat të jenë të mjaftueshme për financimin e energjisë elektrike, personelit, materialeve, mirëmbajtjes dhe kostove të tjera të domosdoshme për funksionimin e sistemit. Kjo përfaqëson hapin e parë dhe më të rëndësishëm drejt forcimit financiar të shoqërisë.

Në tërësi, plani tarifor paraqet një rrugë realiste dhe të zbatueshme drejt mbulimit të plotë të kostove operative, duke respektuar kërkesat rregullatore, kapacitetin pagues të konsumatorëve dhe nevojën për garantimin e vazhdimësisë dhe cilësisë së shërbimit në të katër njësitë operative të Shoqërisë Rajonale UKD.

Tabela 4– Plani i Rregullimit të Tarifave

Kruja-Rrogozhina Kategoria		2026	2027	2028	2029
Familjare					
	Fixed Fee (Lek/muaj)	200	300	300	300
	Uji (Lek/m³)	48	52	55	55
	Kanalizime (Lek/m³)	10	20	22	22
Privat					
	Fixed Fee (Lek/muaj)	300	600	600	600
	Uji (Lek/m³)	100	150	150	150
	Kanalizime (Lek/m³)	20	40	44	44
Publik					
	Fixed Fee (Lek/muaj)	300	600	600	600
	Uji (Lek/m³)	96	150	150	150
	Kanalizime (Lek/m³)	20	40	44	44

CamScanner

Tabela 5– Plani i Rregullimit të Tarifave në %

Kruja-Rrogozhina Kategoria		2027	2028	2029
Familjare				
	Fixed Fee (Lek/muaj)	50%	0%	0%
	Uji (Lek/m³)	8%	6%	0%
	Kanalizime (Lek/m³)	99%	10%	0%
Privat				
	Fixed Fee (Lek/muaj)	100%	0%	0%
	Uji (Lek/m³)	50%	0%	0%
	Kanalizime (Lek/m³)	100%	10%	0%
Publik				
	Fixed Fee (Lek/muaj)	100%	0%	0%
	Uji (Lek/m³)	56%	0%	0%
	Kanalizime (Lek/m³)	100%	10%	0%

Tarifimi me blloqe për SHRUKD-në

Referuar nenit 19 të metodologjisë së ERRU-së, tarifimi me blloqe synon promovimin e përdorimit racional të ujit, mbrojtjen e burimeve ujore dhe reflektimin më të drejtë të kostove operative të shërbimit. Metodologjia parashikon aplikimin e tarifave volumetrike me nivele të diferencuara konsumi për klientët e pajisur me matës individualë, duke krijuar një mekanizëm që orienton konsumatorët drejt përdorimit më eficient të ujit, veçanërisht gjatë periudhave me konsum të lartë sezonal. ERRU gjithashtu inkurajon operatorët që të propozojnë struktura tarifore me blloqe për të diferencuar konsumin bazë nga konsumi intensiv dhe për të përmirësuar qëndrueshmërinë financiare të shoqërive UK

Tabela 6:Struktura e tarifave në blloqe të ndryshme të konsumi dhe kategori klientësh

Kategoria e Klientëve	Familjarë	Publikë	Privatë
Koeficienti i shumëzimit te çmimit për 1 m³ ujë	Konsumi mujor	Konsumi (m³/muaj)	Konsumi (m³/muaj)
1.0	deri 18	Mesatare Historike e Vitit te fundit (MH)	Mesatare Historike Vitit te fundit (MH)
1.0 deri 3.0	18 deri 30	Deri 3-fish e MH	Deri 3-fish e MH
1.5 deri 4.0	Mbi 30	Mbi 3-fish e MH	Mbi 3-fish e MH

Për familjarët, koeficientët mund të variojnë nga 1.0 në bllokun bazë deri në 3.0 për konsumet më të larta. Për klientët privatë dhe publikë, koeficientët mund të arrijnë deri në 4.0 për konsumet mbi nivelet historike të referencës.

Analiza e profileve reale të konsumit për vitin 2025 në Njësinë Operative Durrës evidenton qartë një efekt të fortë sezonal, ku rritja e kërkesës për ujë gjatë muajve të verës nuk shpërndahet proporcionalisht tek të gjithë konsumatorët, por përqendrohet tek segmentet me konsum intensiv. Për kategorinë familjare, shumica dërrmuese e abonentëve mbetet në nivele normale konsumi gjatë gjithë vitit, ndërsa vetëm një segment relativisht i vogël klientësh me konsum mbi 30 m³ gjeneron një pjesë disproporcionale të volumit total dhe të ngarkesës operative mbi sistemin. Për këtë arsye, propozohet që për kategorinë familjare të aplikohet ndarja në dy blloqe:

CamScanner

- 0–30 m³;
- dhe mbi 30 m³.

Kjo qasje shmang ndikimin mbi konsumatorin standard familjar dhe fokuson aplikimin e bllokut të dytë tek segmenti që realisht amplifikon kërkesën gjatë sezonit veror. Analiza e databazës së klientëve tregon se konsumatorët familjarë mbi pragun 30 m³ përfaqësojnë një pjesë relativisht të vogël të totalit të abonentëve, çka e bën këtë prag më të përshtatshëm operacionalisht dhe socialisht krahasuar me kufirin orientues prej 18 m³ të parashikuar në metodologji.

Për kategorinë private dhe institucionale/publike, analiza e profileve të konsumit tregon një strukturë shumë më të përqendruar të volumit tek konsumatorët me përdorim intensiv. Gjatë muajve të verës, segmenti me konsum mbi 300 m³ rezulton të gjenerojë pjesën më të madhe të volumit total dhe të krijojë presionin kryesor operacional mbi sistemin e furnizimit me ujë. Për këtë arsye, propozohet që edhe për kategoritë private dhe publike të aplikohet një strukturë me dy blloqe:

- 0–300 m³;
- dhe mbi 300 m³.

Kjo ndarje konsiderohet më e përshtatshme për të kapur efektin real sezonal dhe për të diferencuar konsumatorët standardë nga konsumatorët me ndikim të lartë operacional. Për kategorinë private dhe publike, sistemi i faturimit mundëson identifikimin e historikut të konsumit për çdo klient dhe krijon bazën teknike për përcaktimin e kufijve të konsumit që do të përdoren në aplikimin e tarifimit me blloqe.

Aplikimi i tarifimit me blloqe, miratuar me vendim të Këshillit Mbikqyrës nr.9 datë 28.05.2026, duhet parë si një mekanizëm i arsyeshëm dhe i justifikuar për:

- shpërndarjen më racionale të kostove të shërbimit sipas profileve reale të konsumit;
- përmirësimin e qëndrueshmërisë financiare të shoqërisë;
- dhe krijimin e një instrumenti më efektiv për menaxhimin e kërkesës gjatë sezonit veror, kur sistemi përballet me ngarkesën më të lartë operative.

Analiza e profileve të konsumit sipas njësive operative tregon se Njësia Operative Kavajë paraqet sjellje shumë të ngjashme me Njësinë Operative Durrës, ku evidentohet qartë efekti sezonal dhe rritja e konsumit intensiv gjatë muajve të verës, veçanërisht tek segmentet mbi kufijtë e propozuar të blloqeve. Ndërkohë, Njësitë Operative Krujë dhe Rrogozhinë paraqesin profil shumë më të qëndrueshëm konsumi, me mbi 95% të konsumatorëve që rezultojnë brenda bllokut të parë të konsumit gjatë pjesës më të madhe të vitit dhe pa evidenca të theksuara të amplifikimit sezonal të kërkesës. Ky dallim konfirmon se efekti sezonal dhe presioni operacional mbi sistemin përqendrohen kryesisht në zonat me aktivitet më të lartë urban dhe turistik.

- **Për kategorinë familjare:**
  - Blloku I: 0–30 m³/muaj;
  - Blloku II: mbi 30 m³/muaj.
- **Për kategorinë private:**
  - Blloku I: 0–300 m³/muaj;
  - Blloku II: mbi 300 m³/muaj.
- **Për kategorinë publike/institucionale:**
  - Blloku I: 0–300 m³/muaj;
  - Blloku II: mbi 300 m³/muaj.

CamScanner

3.1 Vlerësimi i Përballueshmërisë Sociale në përputhje me Metodologjinë e ERRU-së

Analiza e përballueshmërisë është kryer në përputhje me metodologjinë e ERRU-së dhe bazohet në faturën mesatare mujore të një familjeje me konsum standard prej 12 m³/muaj, të krahasuar me të ardhurat mesatare familjare të parashikuara gjatë periudhës së planifikimit. Rezultatet tregojnë se, pavarësisht rritjeve të nevojshme tarifore për të siguruar mbulimin e kostove operative, niveli i përballueshmërisë mbetet dukshëm brenda kufijve të pranueshëm socialë në të gjitha njësitë operative.

Në Krujë dhe Rrogozhinë, ndikimi tarifor është më i dukshëm në vitin e parë të aplikimit, pasi këto njësi nisen nga nivele shumë të ulëta tarifore. Fatura mesatare mujore rritet nga 1,076 lekë në vitin 2026 në 1,397 lekë në vitin 2027, ose rreth 29.8%.

Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se kjo përqindje e lartë reflekton kryesisht bazën shumë të ulët fillestare të faturës dhe jo një barrë të lartë financiare në vlerë absolute. Edhe pas rritjes, fatura mujore mbetet dukshëm më e ulët se në Durrës dhe Kavajë.

Më e rëndësishmja, treguesi i përballueshmërisë mbetet në nivele shumë të favorshme, duke arritur vetëm 1.9% të të ardhurave familjare në vitin 2027 dhe duke qëndruar rreth 2.0% deri në vitin 2031. Kjo konfirmon se edhe pas korrigjimit tarifor, shërbimi mbetet ndër shpenzimet më të ulëta në buxhetin familjar.

Tabela 6–Përballueshmëria Sociale

Përballueshmëria Kavaja	Unit		2026	2027	2028	2029
Konsumi familjar	m3/m		12	12	12	12
Kosto per tarifën fikse	lek/m		200	300	300	300
Kosto për volumetrike per FU, KUN, ITUN.	lek/m		960	1,009	1,080	1,080
Kostot totale për shërbimin me TVSH	lek/m		1,392	1,570	1,656	1,657
Rritja e parashikuar e GDP	%		3.5%	3.5%	3.5%	3.5%
Të ardhurat mesatare të familjes (rritur me GDP-në)	lek/m	71,649	74,157	74,157	76,752	79,438
Përballueshmëria e shërbimit	%		**1.9%**	**2.1%**	**2.2%**	**2.1%**
Ndryshimi i faturës sipas planit tarifor				**12.9%**	**5.5%**	**0.0%**

Mesazhi Kryesor

Analiza tregon se rritjet tarifore të propozuara janë të nevojshme për të siguruar mbulimin e kostove operative dhe vazhdimësinë e shërbimit, por njëkohësisht janë projektuar në mënyrë të kujdesshme për të mbetur socialisht të përballueshme.

- Në Durrës–Shijak, ndikimi maksimal arrin vetëm 2.9% të të ardhurave familjare.
- Në Kavajë, niveli i përballueshmërisë mbetet rreth 2.1–2.2%.
- **Në Krujë dhe Rrogozhinë, edhe pas rritjes më të madhe relative, përballueshmëria mbetet vetëm 1.9–2.0%.**

Në të gjitha rastet, treguesit mbeten ndjeshëm poshtë kufijve të konsideruar problematikë nga praktika ndërkombëtare dhe standardet rregullatore. Kjo do të thotë se propozimi tarifor arrin një ekuilibër të arsyeshëm ndërmjet nevojës për qëndrueshmëri financiare të shoqërisë dhe mbrojtjes së interesit të konsumatorëve, duke garantuar që përmirësimi i shërbimit të realizohet pa krijuar barrë të papërballueshme për familjet.

CamScanner

4.Informacion për investimet e kryera në dy vitet e fundit dhe ato të planifikuara

Lista e projekteve prioritare përbën bazën e ndërhyrjeve strategjike të planifikuara nga SHRUKD vit pas viti, me qëllim përmirësimin e performancës operative, financiare dhe institucionale. Projektet identifikohen në raport me situatën aktuale të aseteve dhe nivelit të urgjencës duke patur parasysh ndikimin në arritjen e objektivave strategjikë, me në fokus reduktimin e ujit pa të ardhura, përmirësimin e planifikimit dhe menaxhimit të aseteve.

4.2 Investime në proçes implementimi

Objekti 1: Investimi AFD /Master Plan Ujra të Ndotura dhe Ujra Shiu, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durres, Bashkia Krujë
Kohëzgjatja studimit: Korrik 2025-Shtator 2026

Investimi përfshin hartimin e Mastër Planit për ujrat e ndotura dhe ato të shiut në gjitha zonën e shërbimit të SHURKD-së, përfshirë zonat urbane dhe rurale në Bashkinë Krujë. Studimi do paraqesë nevojat për investime në drejtimin e zhvillimit të kanalizimeve, ujrave tw shiut dhe impianteve të trajtimit të ndotura.

4.1 Investimet e parashikuara dhe aplikuar për financim

Gjatë vitit 2024 dhe në vazhdim me fond buxhet shtetit dhe autoritet kontraktual Bashkia Rrogozhinë po implmentohen investimet:

Objekti 1: Rikonstruksion i magjistralit kryesor dhe rrjetit të ujësjellësit te fshatrave Lekaj, Harizaj, Kryeluzaj, Zambisht, Okshtun dhe Mushnik të njësisë administrative Lekaj, Bashkia Rrogozhinë

Objekti 2: Rikonstruksion i magjistralit kryesor dhe rrjetit të ujësjellësit te fshatrave Gose e madhe, Gose e vogel, Kalush, Kercukaj, të njësisë administrative Gose, Bashkia Rrogozhinë

Shkëmbyer shkresa zyratare me Bashkinë për informacion mbi projektet dhe miratimin e pikave furnizuese nga burimet e SHRUKD-së. investimet priten të përfundojnë gjatë 2026 duke mbuluar zonat në masën rreth **100%** me rrjet të ri fshatrat e kësaj njësie, kryesisht përmes ndërtimit të **linjave shpërndarëse dhe realizimit të lidhjeve familjare**, me synim për të kaluar në furnizim 24 orë në ditë.

Objekti 3: Sistemi i ri KUZ +ITUP në zonën turistike të Spillesë, Bashkia Rrogozhinë

Investimi me autoritet kontraktual Agjensinë Kombëtëre Ujësjellës Kanalizimeve është në proces shpronësimi. Bëhet i mundur ndërtimi për herë të parë i rrjetit të kanalizimeve në fshatin Spille duke përfshirë dhe zonën turistike. Projekti përfshin dhe ndërtimin e impiantit të trajtimit të ujrave të ndotura.

CamScanner

Objekti 4: Investimi AFD/ Master Plan Ujra të Ndotura dhe Ujra Shiu, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durres

Kohëzgjatja studimit: Korrik 2025-Shtator 2026

Projekti përfshin hartimin e Mastër Planit për ujrat e ndotura dhe ato të shiut në zonën e shërbimit të SHURKD-së, duke përfshirë zonat urbane dhe rurale në Bashkinë Rrogozhinë. Studimi do paraqesë nevojat për investime në drejtimin e zhvillimit të kanalizimeve, ujrave të shiut dhe impianteve të trajtimit të ndotura.

Pasqyra furnizimit me ujë zona rurale Rrogozhine , mbulimi aktual dhe nevojat

Njësia Administrative Sineballaj

Në këtë njësi përfshihen 9-fshatra nga të cilat:

Fshati Sineballaj, mbulohet me rrjet ujesjellesi në masën rreth 100%, investim 2023 rrjet shpërndarës dhe matësa, 24 ore furnizimi

Fshatrat Metasanaj, Hazdushk, Hamenraje, Kocaj-Sheshaj, Thartor, Rrostej, Fliballije, Damarkaj: nuk ofrohet shërbimi i furnizimit me ujë pasi janë shumë larg nga zona urbane dhe furnizohen me burime vetjake (pusshpime).

Njësia Administrative Gosë

Në këtë njësi përfshihen 5-fshatra: Gose e madhe, Gose e vogel, Kalush, Kercukaj, Vile-Boshtove me infrastrukturë furnizimi me ujë ndërtuar ndër vite, me orar furnizimi që variojnë nga 3-4 orë sipas menaxhimit të stacionit të puseve në këto zona.

Investimi i Bashkisë pritet të përfundojë së shpejti duke mbuluar zonat në masën rreth 100% me rrjet të ri fshatrat e kësaj njësie.

Njësia Administrative Lekaj

Në këtë njësi përfshihen 10-fshatra: Lekaj, Harizaj, Germen, Zambish, Mushnik, Mlik, Okshtun, Luz i madh , Shkozet, Kryeluzaj, me infrastrukturë furnizimi me ujë ndërtuar ndër vite, me orar furnizimi që variojnë nga 2-24 orë sipas menaxhimit të stacionit të puseve në këto zona.

Investimi i Bashkisë pritet të përfundojë së shpejti duke mbuluar zonat në masën rreth 100% me rrjet të ri fshatrat e kësaj njësie.

Njësia Administrative Kryevidh

Në këtë njësi përfshihen 10-fshatra: Kryevidh, Ballaj, Rreth-Greth, Patke-Milot, Zhabjak, Spanesh, Spille, Domen , Sterbeg, Shardushk, me infrastrukturë furnizimi me ujë ndërtuar ndër vite, me orar furnizimi që variojnë nga 10-24 orë sipas menaxhimit të stacionit të puseve në këto zona.

Nga Bashkia Rrogozhinë është pregatitur projekt-studimi për rikonstruksionin e rrjetit të furnizimit me ujë të kësaj njësie, duke mbuluar zonat në masën rreth 100% me rrjet të ri.

CamScanner

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RRROGOZHINË
DREJTORIA E FINANCES

Nr. 3669 **Prot.** **Rrogozhinë,më** 11. 09. **2026**

PROJEKT VENDIM

PËR

SUBVENCIONIMIN E QIRASË PËR STREHIMIN E PËRKOHSHËM TË FAMILJEVE, BANESAT E TË CILAVE JANË TË RREZIKUARA NGA RRËSHQITJA E TOKËS NË FSHATIN STERBEG, NJËSIA ADMINISTRATIVE KRYEVIDH, BASHKIA RROGOZHINË

Në mbështetje të,Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë,ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, veçanërisht nenit 54, për kompetencat e Këshillit Bashkiak dhe dispozitave për funksionet e njësisë së vetëqeverisjes vendore,ligjit nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", i ndryshuar, veçanërisht dispozitave që përcaktojnë përgjegjësitë e njësive të vetëqeverisjes vendore për mbrojtjen civile dhe përballimin e pasojave të fatkeqësive,ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social", i ndryshuar, veçanërisht nenit 31, lidhur me subvencionimin e qirasë në rastet e emergjencës për strehim; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,ligjit nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar,
ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; dokumentacionit teknik dhe administrativ të administruar nga Bashkia Rrogozhinë.

TE VENDOSI:

1. Të miratojë subvencionimin e qirasë për strehimin e përkohshëm të familjeve banesat e të cilave janë vlerësuar si të rrezikuara nga rrëshqitja e tokës në fshatin Sterbeg, Bashkia Rrogozhinë.
2. Të miratojë listën e familjeve përfituese, si më poshtë:

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Vendbanimi	Qira mujore	Periudha	Vlera totale
1	Osman Peza	Sterbeg	13,800 lekë	12 muaj	165,600 lekë
2	Faslli Qoshja	Sterbeg	13,800 lekë	12 muaj	165.600 lekë
3	Shkëlzen Peza	Sterbeg	13,800 lekë	12 muaj	165.600 lekë
	TOTAL		41,400 lekë/muaj	12 muaj	496.800 lekë

3. Masa e subvencionimit të qirasë përcaktohet në shumën 13,800 (trembedhjetemijeeteteqind) lekë në muaj për çdo familje përfituese, për një periudhë prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh.
4. Vlera totale e subvencionimit për tre familjet përfituese është 496,800 (katerqindenentedhjeteegjashtemijeeteteqind) lekë.
5. Subvencionimi i qirasë do të kryhet në bazë të dokumentacionit justifikues, përfshirë kontratën e qirasë dhe dokumentet e tjera të kërkuara nga strukturat përgjegjëse të Bashkisë, si dhe në përputhje me rregullat e zbatimit të buxhetit.

CamScanner

6. Përfitimi i përcaktuar në këtë vendim ka karakter të përkohshëm dhe lidhet me nevojën për strehim të sigurt të familjeve për shkak të rrezikut të evidentuar në banesat e tyre.
7. Ngarkohet struktura përgjegjëse për mbrojtjen civile, në bashkëpunim me strukturat sociale dhe administrative të Bashkisë, për verifikimin dhe ndjekjen e vazhdueshme të situatës së familjeve përfituese.
8. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë për zbatimin e këtij vendimi.
9.Ngarkohet Drejtoria e Financës për planifikimin, angazhimin dhe realizimin e pagesave, në përputhje me fondet e miratuara në buxhet dhe legjislacionin në fuqi për menaxhimin financiar dhe kontrollin.
10. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit.

N/KRYETAR I BASHKISË
USHTRUES I DETYRËS SË KRYETARIT
Andi **PROSHKA**

CamScanner

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
DREJTORIA E FINANCES

Nr. 3669/1 **Prot.** **Rrogozhinë,më** 11.09.**2026**

Relacion Shpjegues:

PËR SUBVENCIONIMIN E QIRASË PËR STREHIMIN E PËRKOHSHËM TË FAMILJEVE TË RREZIKUARA NGA RRËSHQITJA E TOKËS NË FSHATIN STERBEG

E nderuar Kryetare e Këshillit Bashkiak,
Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Në territorin e fshatit Sterbeg, Bashkia Rrogozhinë, është evidentuar një situatë e krijuar nga rrëshqitja e tokës, e cila paraqet rrezik për sigurinë e banorëve dhe për përdorimin normal të disa banesave.
Nga vlerësimet dhe konstatimet e strukturave përgjegjëse të Bashkisë rezulton e nevojshme marrja e masave për largimin e përkohshëm të familjeve nga banesat e rrezikuara dhe sigurimin e një strehimi alternativ, deri në vlerësimin dhe zgjidhjen e situatës së krijuar.
Në këto kushte, Bashkia Rrogozhinë vlerëson se sigurimi i një mbështetjeje financiare për pagesën e qirasë është një masë e nevojshme për garantimin e sigurisë së familjeve të prekura.
Ligji nr. 22/2018, "Për strehimin social", parashikon mundësinë e subvencionimit të qirasë nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, me miratimin e këshillit vendor, ndër të tjera kur familja ndodhet në kushtet e emergjencës për strehim dhe nuk përfiton nga një program tjetër.
Gjithashtu, kuadri ligjor për mbrojtjen civile i ngarkon njësitë e vetëqeverisjes vendore me përgjegjësi për marrjen e masave për mbrojtjen e popullsisë dhe për përballimin e pasojave të fatkeqësive në territorin e tyre.
Për këtë qëllim propozohet trajtimi me subvencionim qiraje i 3 familjeve, konkretisht:
Osman Peza;
Faslli Qoshja;
Shkëlzen Peza.
Masa e propozuar është 13,800 lekë në muaj për çdo familje, për një periudhë prej 12 muajsh.
Përllogaritja financiare është:
3 familje × 13,800 lekë × 12 muaj = 496,800 lekë.
Për rrjedhojë, kërkohet miratimi i Këshillit Bashkiak për subvencionimin e qirasë në shumën totale 000 lekë, me qëllim sigurimin e strehimit të përkohshëm dhe garantimin e sigurisë së familjeve të prekura.
Per sa me siper,
i propozohet Këshillit Bashkiak të Bashkisë Rrogozhinë shqyrtimi dhe miratimi i projekt-vendimit bashkëlidhur.

Ju falemnderit!
Për Drejtorinë e Financës
Drejtori
Rezart VOGLI

CamScanner